

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Raporti Vjetor i RrGGK 2015



© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2016

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, duke u cituar autorët.

www.womensnetwork.org

Printuar në letër të riciklueshme nga Night Design në Prishtinë, Kosovë

Printuar me mbështetjen e:



PËRMBAJTJA

LETRA E KRYETARES SË BORDIT TË RrGGK.....	7
HYRJE.....	10
Rreth Raportit Vjetor të RrGGK.....	11
NGRITJA E KAPACITETEVE TË RrGGK.....	12
Solidariteti në mes të organizatave të grave në Kosovë është rritur.....	12
Është përmirësuar klima e financimit për organizatat për të drejtat e grave	26
RRITJA E PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE	27
Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel komunal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore.....	27
Përmirësimi i institucionalizimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në Kosovë	38
PËRMIRËSIMI I QASJES SË GRAVE NË KUJDESHIN SHËNDETËSOR CILËSOR	41
Zyrtarët publik dhe institucionet shëndetësore të jenë më përgjegjëse në adresimin e shkeljes së të drejtave të grave për kujdes shëndetësor.....	41
Më tepër gra të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor.....	43

JETA PA DHUNË NË BAZA GJINORE	45
Zbatimi i kornizës ligjore të dhunës në familje, duke përfshirë përgjigjet institucionale në ndihmën ndaj personave që kanë pësuar dhunë, është përmirësuar	45
Ndërgjegjësimi dhe vëmendja në trajtimin e dhunës në baza gjinore në mesin e zyrtarëve dhe qytetarëve është përmirësuar, duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual	49
Politikat dhe procedurat e përmirësuara për trajtimin e ngacmimit seksual ekzistojnë	50
Mbështetja institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës është përmirësuar	51
MBËSHTETJA PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE	54
Më shumë gra sigurojnë punësim	54
Më shumë gra kanë qasje në trashëgimi dhe pronësi	57
Përmirësohet qasja e grave në burimet familjare RrGGK ka punuar në ngritjen e fondeve në këtë aspekt të strategjisë së saj gjatë këtij viti, gjë që ende nuk ka dhënë sukses, pamarrëparasysh propozimet e shumta të dorëzuara në vitin 2015.....	59
Përmirësohet shkalla në të cilën politikat dhe programet e BE-së përfshijnë perspektivën gjinore....	60
VLERËSIMI I PUNËS SË RrGGK.....	61
RAPORTI FINACIAR I RrGGK PËR VITIN 2015	62
PËR NE	73

Bordi Drejtues i RrGGK	73
Bordi Këshillëdhënës i RrGGK	73
Anëtarët e Stafit të RrGGK në vitin 2014	73
Anëtarët e Stafit të Iniciativës së Historisë Gojore të Kosovës (Financuar nga RrGGK)	74
Praktikantët që kanë punuar vullnetarisht për RrGGK në vitin 2015	75
Persona të tjerë që kanë punuar vullnetarisht për RrGGK në vitin 2015	75
Hulumtuesit dhe anketuesit e RrGGK për një periudhë të shkurtër kohore	75
Anëtarët/et Individual/e të RrGGK	76
Organizatat Anëtare të RrGGK	77
Shtojca 1. Grantet e Fondit të Grave të Kosovës në vitin 2015	87
Shtojca 2. Të arriturat e avokimit nga Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë në vitin 2015	105

Raporti Vjetor i RrGGK 2015

LETRA E KRYETARES SË BORDIT TË RrGGK

Të nderuara OJQ anëtare dhe staf i Rrjetit,

Edhe një vit të suksesshëm po e lëmë mbrapa vetës me krenari. Nevojat dhe interesat e grave dhe vajzave janë natyrisht të ndryshueshme dhe kanë evoluar me kohën por edhe Rrjeti ka arritur të realizojë një përcjellje të vazhdueshme të këtyre nevojave. Si një grup i ndryshueshëm por edhe në nevojë, që të përfaqësohet në proceset e ndryshme vendimmarrëse, besoj se Rrjeti ia ka dalë denjësisht edhe këtë vit të jetë pranë grave dhe vajzave dhe të i transmetojë këto nevoja më së miri. Me transparencë, llogaridhënie dhe debat të vazhdueshëm, Rrjeti mbetet një zë i denjë i nevojave të grave dhe vajzave dhe grupeve tjera më të ndjeshme, përfshirë këtu edhe komunitetin jo-shumicë.

Por, ende mbesin mjaft sfida. Megjithatë, do të doja të ktheheshim në disa prej sukseseve që i lamë pas që shënuan vitin 2015. Edhe këtë vit Rrjeti ka vazhduar të përkrah Fondin e Grave të Kosovës, një fond i cili iu ka ofruar mundësinë grave në të gjitha nivelet sikurse në zona rurale, por edhe qytete që të ndihet zëri i grave të cilat shpesh harrohen në procese vendimmarrëse në nivelin lokal dhe atë qendror. Shumë organizata të grave nuk kishin mundësi të organizonin aktivitetet e tyre, në mungesë të



fondeve bazike që do të ndihmonte punën e tyre. Sot, ato OJQ kanë arritur ta bëjnë këtë nëpërmjet menaxhimit të mirëfilltë të Fondit nga ana e Rrjetit, si dhe vazhdimit të përkrahjes nga një numër i donatorëve, dhe ofrimin e vazhdueshëm të besimit në punën e Rrjetit.

Poashtu, për herë të parë në Kosovë, kemi një planifikim dhe analizë të buxhetit nga aspekti gjinor si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror. Falë angazhimit direkt të stafit dhe anëtareve të Rrjetit, është ofruar një alternativë paksa më ndryshe që vendimmarrësit në Kosovë, [që fatkeqësisht ende vazhdojnë të janë në shumicë burra dhe jo shpesh të kuptueshëm për nevojat dhe interesat e grave dhe vajzave], të kenë mundësinë të shohin dhe kuptojnë se si po bëhet shpërndarja e resurseve të parave tona si taksapagues, si dhe sesi po shpërndahet buxheti në nivelin lokal dhe qendror për burrat dhe gratë. Sepse, nëse kemi shpërndarje të barabartë të këtyre resurseve, do të kemi edhe zhvillim të barabartë.

Këto ndryshime sado të vogla që mund të na duken, janë në fakt veprime që Rrjeti i ka promovuar dhe kërkuar për një kohë të gjatë. Si në shembullin e zgjedhjes së fundit të qeverisë kanadeze ku është treguar se një ndarje e barabartë dhe qeverisje 50:50 gra dhe burra, tregon shkallën e zhvillimit të një shoqërie të shëkullit 21; ne tani e kemi Ligjin për Barazi Gjinore që promovon pjesëmarrjen e barabartë edhe në Kosovë, dhe Rrjeti do të vazhdon ta përkrahë dhe promovon zbatimin dhe përdorimin sa më të gjerë të Ligjit.

Dhe së fundi besoj që Rrjeti edhe këtë vit ka treguar se kur ka strategji të qartë, punë dhe vizion, atëherë ka edhe udhë-përshkrim të suksesshëm. Por ne kemi edhe shumë për çka të shqetësohemi. Në rolin mbikëqyrës që kemi për realizimin e të drejtave të grave dhe vajzave, por edhe grupeve të ndjeshme si djemve të rinj dhe të të moshuarve, Rrjeti ka vazhduar të mbledh, avokon dhe hulumton me fakte pozitive jo të mirë të viktimave të dhunës në baza gjinore. Për më tepër, për të ofruar një pasqyrë reale të gjendjes së viktimave

të dhunës, Rrjeti ka botuar raportin gjithëpërfshirës dhe bazik lidhur me incidencën dhe qëndrimet mbi dhunën në familje nga ana e institucioneve të Kosovës. Me avokim të bazuar në fakte, Rrjeti ka vazhduar të kërkojë drejtësi për viktimat që sot nuk janë më me ne, për shkak të drejtësisë së vonuar, dhe andaj të mohuar sikurse në rastin e Zejnepe Zejnullahu nga Suhareka e cila u vra nga bashkëshorti i saj, dhe vajzës së saj e cila u plagos duke e mbrojtur nënën e saj! Shpresojmë se kjo drejtësi nuk do të vonohet më, dhe do të kemi përgjigje institucionale me kohë, si dhe dënime adekuate në përputhshmëri me Ligjin. Sepse, nuk ka më arsye të mos zbatuar ligjin dhe për të mos ofruar shanse të barabarta për rritjen dhe zhvillimin e sigurt të djemve dhe vajzave!

Me moton që të ndërtojmë një shoqëri ku gratë dhe vajzat e reja, dhe grupet e ndjeshme do të kenë mundësinë të realizojnë potencialin e tyre të plotë dhe të japin kontributin e tyre për një shpërndarje më të barabartë të resurseve shoqërore, do të arrijmë të jetojmë në një vend më përfaqësues dhe demokratik.

Ju dëshiroj punë të përgjegjshme dhe suksese në vitin që po vjen, me dëshirën që motoja e jonë të bëhet realitet.

Ariana Qosaj-Mustafa



HYRJE

Vizioni i RrGGK

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) parasheh që në shtetin e Kosovës gratë dhe burrat të jenë të barabartë dhe të kenë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje në politikë, kujdes shëndetësor dhe një jetë pa dhunë.

Misioni i RrGGK

Misioni i rrjetit është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, feja, mosha, niveli i arsimit, orientimi seksual dhe aftësitë. RrGGK përmbush misionin e saj përmes shkëmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, hulumtimeve, avokimit dhe të shërbimeve.

Strategjia e RrGGK

për të përmbushur vizionin dhe misionin e saj, RrGGK ka hartuar Strategjinë për periudhën 2015-2018 (të cilën mund ta gjeni në uebfaqen tonë). Qëllimi i kësaj strategjie është që të drejtojë punën e RrGGK-së gjatë kësaj periudhe. Strategjia është përpiluar në vitin 2014 me të dhëna nga organizatat anëtare të rrjetit, bordi drejtues, partnerët dhe palët tjera relevante. Kjo strategji e RrGGK-së është e ndarë në pesë fusha programatike: I) Ngritja e kapaciteteve të RrGGK; II) Gratë në politikë dhe vendim-marrje; III) Shëndeti i grave; IV) Dhuna në familje dhe trafikimi; dhe V) Fuqizimi ekonomik i grave.



Rreth Raportit Vjetor të RrGGK

Çdo vit Rrjeti raporton te anëtarët e veta, te partnerët dhe miqtë lidhur me përparimin që është bërë drejt arritjes së objektivave strategjike. Ky raport f përmban informata lidhur me aktivitetet e RrGGK nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit 2015. Ky raport është i ndarë në pesë pjesë në të cilat përfshihen objektivat afatgjata të rrjetit:

- Ngritja e kapacitetit të programit të RrGGK-së
- Gratë në Politikë dhe Vendimarrje
- Të Drejtat e Grave në Kujdesin Shëndetësor
- Programi kundër Dhunës në Baza Gjimore
- Fuqimizimi Ekonomik i Grave

Në këtë raport, prezantohen të arriturat dhe rezultatet për vitin 2015, lidhur me secilin nga këto programe. Çdo pjesë e tij përmban informata lidhur me progresin e bërë drejt çdo rezultati të pritur (nën-titujt me fontin bold) dhe rezultati (nën-titujt me fontin italic). Gjithashtu, reflekton të arriturat në Strategjinë 2015-2018. Raporti gjithashtu përmban informata rreth buxhetit, mbështetësve, Bordit të Drejtorëve, Bordit Këshillëdhënës, stafit, praktikanteve, vullnetareve, anëtareve dhe përfituesve të granteve.



NGRITJA E KAPACITETEVE TË RrGGK

Qëllimi kryesor i programit për ngritjen e kapaciteteve të RrGGK është që: të egzistojë një lëvizje e qëndrueshme e grave në Kosovë. Një indikatorë që tregon se RrGGK ka bërë progres në arritjen e këtij qëllimi është fakti që zbatimi i Strategjisë së RrGGK për vitet 2015-2018 është rritur nga 0% në 60%, bazuar në indikatorët për vitin 2015.

Më tutje, numri i anëtarëve individual të RrGGK-së është rritur nga 36 në 38; si dhe vajzat e djemtë kanë ndërmarrë iniciativa për mbështetjen e lëvizjes, duke treguar që gjeneratat e ardhshme kanë kapacitete që të vazhdojnë këtë lëvizje. RrGGK dhe anëtarët e Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë kanë qenë aktive edhe këtë vit. Në vitin 2015, RrGGK kishte qëllimet dhe rezultatet e mëposhtme, të cilat kontribuan në arritjen e këtij qëllimi kryesor, siç është paraparë me Strategjinë tonë.

Solidariteti në mes të organizatave të grave në Kosovë është rritur

Përvoja e RrGGK-së tregon që përkrahja dhe ruajtja e solidaritetit në mes të organizatave të grave janë vendimtare për ndërtimin e një lëvizjeje të qëndrueshme të grave, që nuk bëhet pre e përgojimeve apo që konkurrenca nuk ia minon përpjekjet drejt qëllimeve të përbashkëta. RrGGK ka shënuar progres drejt arritjes së këtij rezultati përmes arritjes së rezultateve të pritshme të shënuara më poshtë.



Anëtarët e RrGGK të informuara për nismat e anëtareve tjera, aktivitetet e RrGGK, mundësitë e financimit dhe informacione të tjera

RrGGK ka organizuar pesë takime të rregullta dymujore të anëtareve, përmes të cilave 363 anëtare, partnerë dhe përkrahës të ndryshëm kanë shkëmbyer informata; u organizuan së paku nëntë iniciativa të përbashkëta; dhe u informuan për aktivitetet që po zhvilloheshin në vazhdimësi nga RrGGK dhe nga organizatat tjera. Gjatë takimeve, anëtarët e RrGGK-së luajtën rol të rëndësishëm në bashkëpunimin drejt zbatimit të strategjisë së RrGGK-së, si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e punës së RrGGK-së.

Më shumë vajza të reja aktiviste të përfshira në RrGGK, FemACT

RrGGK rregullisht ka postuar në faqen e Facebook-ut të FemACT dhe është munduar të përfshijë vajza dhe djem në aktivitetet në nivel lokal dhe qendror. RrGGK ka ofruar punë praktike për dhjetë vajza. Kjo iu ka dhënë atyre mundësinë që si pjesë e lëvizjes së grave në Kosovë, të aftësohen në organizim dhe avokim.



Forcimi i mirëkuptimit ndëretnik dhe bashkëpunimi ndërmjet individëve dhe grupeve të shoqërisë civile në Kosovë dhe Serbi

RrGGK ka vazhduar përkrahjen e Gjykatës së Grave, përfshirë edhe përkrahjen për pjesëmarrjen e pesë grave kosovare në Gjykatën e Grave në Sarajevë, për të dëshmuar. Kjo u financua nga Heart and Hand Foundation përmes RrGGK-së; UN Women mbështeti drejtëpërdrejtë blerjen e biletave për pjesëmarrëset. RrGGK, e përkrahur nga Kvinna till Kvinna e Suedisë, poashtu ka vazhduar rrjetëzimin rajonal, veçanërisht lidhur me procesin e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian.

RrGGK poashtu ka kontribuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndëretnik përmes Iniciativës së Historisë Gojore të Kosovës, që është një arkiv në internet i historive jetësore të kosovarëve të ndryshëm. Faqja e internetit të Iniciativës së Historisë Gojore (<http://oralhistorykosovo.org/>), përmban intervista të xhiruara; transkripta në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe; rrëfime të shkurta; dhe fotografi që paraqesin jetën e përditshme të personave kosovarë të intervistuar.

Ajo synon të zgjerojë spektrin e historisë së Kosovës përtej luftës së fundit, duke treguar historitë dhe përvojat e përditshme jetësore të grave dhe burrave të ndryshëm. Këtë vit arkivi u pasurua edhe me 27 intervista të reja të kosovarëve, duke përfshirë gratë që ishin aktiviste apo mësuese që prej Luftës së Dytë Botërore. Si dhe transkripta shtesë janë publikuar në internet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. U shkëmbyen përvoja dhe u zgjerua bashkëpunim me studiues, akademikë dhe përfaqësues të shoqërisë civile në Serbi të cilët kanë kontribuar në zgjerimin e arkivit, veçanërisht në gjuhën serbe. Kjo mund të kontribuojë në mirëkuptimin ndëretnik të përvojave të ndryshme të jetuara nga njerëzit në Kosovë.

Në bashkëpunim me Programin për Studime dhe Hulumtime Gjinore të Universitetit të Prishtinës, kjo Iniciativë organizoi punëtorinë dy ditore për studentë mbi metodologjinë e historisë gojore. Hulumtimi këtë vit u fokusua në Luftën e Dytë Botërore, ku kishin mundësinë të kontribuonin edhe studentët. Më pas, në shtator, në bashkëpunim me Programin për Studime dhe Hulumtime Gjinore, Forumin ZDF dhe Alter Habitus, kjo iniciativë organizoi një konferencë dyditore lidhur me memorien kolektive në Prishtinë, ku u prezantua hulumtimi. Historiani ndërkombëtarisht i njohur i historisë gojore, Dr. Alessandro Portelli, poashtu mbajti një ligjëratë dhe kurs në Prishtinë.

E nisur fillimisht si një bashkëpunim kryesisht vullnetarë në mes të RrGGK-së dhe *New School for Public Engagement* në New York, kjo Iniciativë u mbështet edhe nga përkrahës individual, dhe më pas nga National Endowment for Democracy dhe Forumi ZFD prej vitit 2015. Në korrik, Iniciativa e Historisë Gojore u regjistrua si një shoqatë e pavarur. Nga viti 2016, ajo do ta vazhdojë punën në mënyrë të pavarur.

RrGGK poashtu ka ofruar mundësi për bashkëpunim ndëretnik përmes organizatave që kanë pranuar grante përmes Fondit të Grave të Kosovës: Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut (MWAHR), me staf të përbërë nga persona të etniciteteve të ndryshme (shqiptarë, serb dhe boshnjakë) ka bashkëpunuar për të thyer stereotipet për gratë në politikë dhe poashtu për të përkrahur pjesëmarrjen e grave në procese vendimmarrëse në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Si rezultat, ato së bashku krijuan Rrjetin e Grupeve të Grave Asambleiste. Një tjetër shembull është edhe bashkëpunimi i suksesshëm në mes të OJQ Dera e Hapur dhe Ruka Ruci, të cilat janë duke zbatuar iniciativën e tyre të dytë të përbashkët, për fuqizimin e grave shqiptare dhe serbe nga fshatrat e Prishtinës, duke i mbledhur ato së bashku dhe duke iu mësuar aftësi lidhur me avokimin për çështjet që ato i konsiderojnë prioritare.




Është përmirësuar kapaciteti organizativ i RrGGK dhe anëtareve të saj drejt avokimit dhe qëndrueshmërisë afatgjate të rrjetit

Një lëvizje e qëndrueshme e grave nuk mund të ekzistojë pa anëtarët e saj që e mbajnë gjallë lëvizjen. Prandaj, RrGGK vazhdimisht mbështetë anëtarët e saj në avancimin e kapaciteteve të tyre. Punëtoritë, sesionet e mentorimit dhe Fondi i Grave të Kosovës kanë përkrahur anëtarët e RrGGK-së në avancimin e organizatave të tyre.

Puna e RrGGK dhe e anëtareve të saj më e promovuar tek partnerët potencial, tek aktivistët e grave në mbarë botën dhe tek përkrahësit potencial

RrGGK rregullisht ka promovuar punën e anëtareve të saj në faqen e internetit të RrGGK-së, faqen e Facebook-ut, dhe buletin elektronik mujor *Zëri i Grave Kosovare*. RrGGK ka rritur numrin e ndjekësve në Facebook nga 3,995 sa ishin në vitin 2014 në 5,595 në vitin 2015. Faqja FemACT e RrGGK-së në Facebook ka 853 ndjekës. RrGGK gjithashtu menaxhon

Grafiku 1. Ndjekësit e faqes së RrGGK në Facebook gjatë vitit 2015, sipas moshës dhe gjinisë



faqen e Lobit për Barazi Gjinore [Lobby for Gender Equality] që tani ka 997 ndjekës. RrGGK tashmë është aktive edhe në rrjetet tjera sociale përfshirë Twitter (ku ka 360 ndjekës) dhe Instagram (500 ndjekës).

Në janar të vitit 2015, RrGGK ka ndryshuar mënyrën se si e kalkulon përdorimin e uebfaqes. Këtë vit RrGGK ka pasur 6,517 vizitorë të faqeve; 2,256 sesione; dhe 1,605 përdorues.

RrGGK rregullisht ka shkruar artikuj për anëtarët e saj në buletin tonë mujor *Zëri i Grave Kosovare*, i cili lexohet nga qindra njerëz nëpër botë. RrGGK poashtu ka dërguar 27 kumtesa për media gjatë vitit 2015:

1. RrGGK reagon ndaj gjuhës së urrejtjes të përdorur nga z. Jabllanoviq (16 janar)
2. Lobi për Barazi Gjinore i bashkangjitet protestës së shoqatës “Thirrjet e Nënave” (23 janar)
3. RrGGK dënon dhunën që ndodhi pas përfundimit të protestës mbarëpopullore të 24 janarit (26 janar)
4. RrGGK dënon dhunën e policisë të ushtruar sot ndaj protestuesve paqësor (27 janar)
5. Marshimi One Billion Rising (Një Miliardë në Këmbë) (13 shkurt)
6. RrGGK reagon ndaj komenteve të Ministrit për Zhvillim Ekonomik, Blerand Stavileci (27 shkurt)
7. RrGGK uron Arbana Xharrën për çmimin “Gra të Guximshme” (6 mars)
8. RrGGK kërkon hetimin e rastit skandaloz në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike të QKUK-së (6 mars)
9. RrGGK dënon portretizimin e grave, vajzave dhe fëmijëve nga mediat online në Kosovë (7 mars)
10. RrGGK uron Nënkryetaren e posazgjedhur në Kuvendin e Kosovës, zn. Aida Dërguti (12 mars)
11. RrGGK reagon mbi ribotimin e tekstit universitar të “Kriminalistikës” (22 prill)
12. Vazhdon mbledhja e fustanave dhe fundeve si kontribut për instalacionin artistik “Mendoj për ty” (27 maj)



13. Ligji i ri i Kosovës për Barazi Gjinore: Të mirat, të kqijat, të diskutueshme (5 dhe 6 gusht)
14. Letër e hapur: RrGGK shpreh shqetësimin e thellë lidhur me ri-traumatizimin e pamëshirshëm të banorëve të Krushës së Vogël, në radhë të parë të grave, nga ana e EULEX-it (27 gusht)
15. RrGGK dhe LBGj dënojnë rëndë kërcënimin me jetë të Zn. Kusari - Lila (30 shtator)
16. RrGGK kërkon drejtësi për krimin në Therandë (25 tetor)
17. RrGGK dënon faktin që gratë deputete tolerojnë fjalorin diskriminues në Kuvendin e Kosovës (27 tetor)
18. Ftohen qytetarët të kontribuojnë në Ligjin e ri të Punës përmes një hulumtimi shumë të rëndësishëm (28 tetor)
19. Fillon Konferenca Regionale “Freja Forum 2015” (6 nëntor)
20. RrGGK dhe LBGj dënojnë rëndë kidnapimin e vajzës së deputetes Emilija Redžepi (10 nëntor)
21. 14 organizata të grave marrin grante nga Raundi i tetë i Fondit të Grave të Kosovës (18 nëntor)
22. RrGGK kundërshton vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për ndërtimin e burgut brenda Repartit të Gjinekologjisë në QKUK (19 nëntor)
23. RrGGK do të publikojë raportin e ri mbi dhunën në familje: “Mjaft më me arsye time (20 nëntor)
24. RrGGK publikon raportin e ri mbi dhunën në familje: “Mjaft më me arsye time (23 nëntor)
25. RrGGK publikon raportin e ri “Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale” (3 dhjetor)
26. RrGGK organizon Kuvendin Vjetor të 13-të të Anëtareve (18 dhjetor)
27. RrGGK mbajti Kuvendin Vjetor të 13-të të Anëtareve RrGGK dhe Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë kërkojnë zbardhjen e rastit të gjetjes së trupit të pjetë të Donjeta Pajazitit, dhe solidarizohen me familjen e saj dhe me qytetarët e Deçanit (19 dhjetor)

RrGGK është përpjekur që të gjitha publikimet dhe shumë prej informatave të publikuara në internet (shpeshherë edhe me mungesë të fondeve për përkthim) t'i ketë në dispozicion në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht.

Anëtares e RrGGK aftësohen për të ngritur fonde, për të planifikuar në mënyrë më efektive, për të udhëhequr organizata dhe për të ndërmarrë iniciativa më efektive avokuese

Duke u bazuar në të arriturat e viteve paraprake, RrGGK, përmes Fondit të Grave të Kosovës ka vazhduar të përkrahë organizatat e veta anëtare në zhvillimin e kapaciteteve të tyre për ngritje të fondeve, planifikim dhe avokim. Organizatat anëtare të RrGGK-së janë aftësuar të përpilojnë strategji efektive të avokimit; të krijojnë partneritete për ndryshim; të dizajnojnë materiale promovuese; të përfshijnë perspektiven gjinore në politika publike; dhe të përdorin teknologjinë informative dhe të komunikimit (TIK). Disa organizata kanë sfiduar vetën duke zhvilluar për herë të parë hulumtim, duke i analizuar të dhënat e hulumtimit, dhe duke i prezantuar të gjeturat e tyre tek palët e ndryshme të interesit. Kjo iu ka mundësuar atyre që të avokojnë në mënyrë më profesionale dhe duke u bazuar në fakte.



Këtë vit, përmes Fondit të Grave të Kosovës, RrGGK ndau 20 grante. Prej tyre, nëntë Grante në Partneritet për Ndryshim (deri më 8,000 €) iu ndanë 18 organizatave që punuan në partneritet dhe 11 Grante Avokimi Individual (deri në 3,000 €) iu ndanë organizatave individualisht. Grantet në Partneritet për Ndryshim kanë rritur bashkëpunimin në mes të

organizatave anëtare, duke iu mundësuar organizatave nga rajone të ndryshme të Kosovës t'i bashkojnë forcat dhe të përforcojnë iniciativat e tyre duke avokuar së bashku. Për shembull, Artpolis dhe organizata Femrat Aktive të Gjakovës kanë përpiluar strategji të përbashkët avokuese për të shtyer përpara procesin e ndërtimit të mekanizmave kundër ngacmimeve seksuale në Universitetin e Prishtinës dhe atë të Gjakovës.

Mbështetësit kryesor të Fondit të Grave të Kosovës për këtë vit ishin Austrian Development Agency (ADA) dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, të cilët kontribuan me vlerën 97,683 €.



Gjatë vitit 2015, RrGGK i ndau anëtarëve të saj 20 grante përmes FGK, në vlerë prej 97,682.95€.

Nga vjeshta e vitit 2012 deri me 31 dhjetor 2015, si rezultat i këtyre iniciativave kanë përfituar 8,084 persona, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, personat nga zonat rurale, personat e etnive të ndryshme (turq, goranë, serbë, romë, ashkali, egjiptianë, boshnjakë dhe shqiptarë), të rinjë dhe pensionerë.

Në vitin 2015, stafi i RrGGK ka ofruar 226 sesione mentorimi dhe ka pasur 410 kontakte me organizatat përfituese të Fondit të Grave të Kosovës. Komisioni për Shqyrtimin e Granteve, i përbërë prej 7 anëtarëve, poashtu ka kontribuar në avancimin e kapaciteteve të anëtarëve, duke shqyrtuar secilin aplikacion dhe duke dhënë këshilla praktike. Kjo ka ndihmuar anëtarët e RrGGK që të dorëzojnë aplikacione më të forta tek Fondi i Grave të Kosovës, si dhe tek donatorë të tjerë. Së paku gjashtë organizata anëtare kanë aplikuar tek donatorë tjerë dhe pesë prej tyre kanë fituar mbështetje financiare për iniciativat e tyre.

Më tutje, deri më 30 nëntor, anëtarët e RrGGK-së të mbështetura nga Fondi i Grave të Kosovës, kanë arritur këto rezultate gjatë vitit 2015:

- *Partners Center for Conflict Management, Partners-Kosova* i kanë informuar 60 gra, burra, vajza dhe djem nga Rahoveci dhe Malisheva se si të avokojnë për të drejtat e grave në ndarjen e pronës dhe trashëgimisë. Si rezultat, një grua nga Malisheva ka marrë guximin që ta dërgojë çështjen në gjyq duke i ndjekur të gjitha procedurat e rregullta gjyqësore.
- Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim, ka mbledhur 13 gra shqiptare dhe serbe, duke i mësuar se si të avokojnë së bashku për çështjet e tyre më prioritare. Trajnimi iu mësoi atyre aftësitë që iu nevojiteshin që të avokojnë tek Kryetari i Komunës së Novobërdës për tri çështje: 1) që kiosku i vendosur në qendrën turistiko-informative në Novobërdë (nga projekti i kaluar i FEZH i mbështetur nga FGK), të



ri-vendoset dhe ri-hapet afër ndërtesës së Komunës; 2) që Kryqi i Kuq të jetë më transparent në aktivitetet e tyre; dhe 3) të organizohen të paktën dy takime për të drejtat e grave në ndarjen e pronës dhe trashëgimisë, me ndihmën e komunës. Ata po presin që këto çështje të adresohen.

- Organizata Psikoterapeutët në Veprim ju ofroi 156 vajzave dhe 66 djemve nga Gjilani mësimet se si të identifikojnë një situatë të mundshme të trafikimit dhe se si t'i shmangin situatat e rrezikshme të të qenit viktimë e trafikimit. Organizata gjithashtu ka avokuar dhe ka ngritur vetëdijen e institucioneve të qeverisjes lokale në Gjilan për nevojën egzistuese për rritjen e masave parandaluese me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve, veçanërisht të të rinjëve, nga trafikimi.
- Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës ka informuar 56 persona për të drejtat e personave të verbër për transport falas, sipas Nenit 13 të Ligjit për Personat e Verbër. Si rezultat, KGVK dhe anëtarët e saj për herë të parë janë takuar me gratë deputete dhe asambleistët e Prishtinës, me ç'rast kanë kërkuar mbështetje prej tyre në zbatimin e këtij neni. Gratë politike janë zotuar që do t'i mbështesin gratë e verbëra. Organizata gjithashtu ka avokuar me sukses tek Kryetari i Komunës të Prishtinës që autobusët e trafikut urban që do të blihen në vitin 2015 t'i plotësojnë nevojat e personave me nevoja të veçanta. Kryetari i Komunës së Prishtinës ju ka premtuar që kërkesat e tyre do të merren parasysh. Hapi i parë i bërë në këtë drejtim deri më sot është krijimi i shtigjeve të veçanta për personat e verbër në disa trotuare, gjë që ka ndodhur për herë të parë në Prishtinë.
- Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut informoi 35 gra dhe nëntë burra nga Mitrovica Veriore për rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në proceset politike. Për të përforcuar bashkëpunimin në mes të grave politike, ato krijuan Grupet e Grave Asambleiste në katër komuna të Mitrovicës së



Veriut dhe më pas krijuan Rjetin e Grupeve të Grave Asambleiste. Në këtë mënyrë, gratë politike atje, mund t'i bashkojnë forcat dhe të punojnë së bashku në mbrojtjen e të drejtave të grave. Kjo organizatë poashtu ka avokuar për krijimin e zyrave për Barazi Gjinore në këto katër komuna.

- Qendra për Zhvillim Rural ka avokuar tek Komuna e Novobërdës që gratë nga ky rajon të përfitojnë grante për biznes.
- Ruka Ruci dhe Dera e Hapur kanë krijuar 6 grupe të grave të komunitetit shqiptarë dhe serb nga tre fshatra të Komunës së Prishtinës dhe tre fshatra të Komunës së Graçanicës. Këto grupe kanë identifikuar disa çështje të një rëndësie të madhe për gratë që jetojnë në këto vende dhe poashtu janë takuar me përfaqësues të departamenteve të komunave të Prishtinës dhe Graçanicës, ku kishin mundësinë të mësonin për rolin e tyre. Këto takime poashtu kanë shërbyer për të diskutuar mekanizmat ekzistues të pjesëmarrjes dhe atë se si të forcohet bashkëpunimi i dyanshëm i grave mbi zhvillimin dhe zbatimin e politikave. Për më tepër, 450 gra nga këto fshatra përfituan nga sesionet vetëdijësuese mbi të drejtat e grave.
- Shoqata Iniciativa e Grave për herë të parë ka kryer një hulumtim mbi çështjet e shëndetit të grave në Dragash, me 170 respondentë. Hulumtimi ka treguar se vetëm 15.29% e respondentëve kanë njohuri për Ligjin No. 04/L-125 mbi shëndetin. Kur u pyetën se çka do të ndryshonin në sistemin e shëndetësisë, respondentët i dhanë prioritet faktit që institucionet shëndetësore duhet të kenë furnizim të rregullt me medikamente mjekësore, standarte më të larta të higjienës, të punësojnë gra mjeke, të kenë kujdes shëndetësor etj. Shoqata Iniciativa e Grave prezantoi këto të dhëna tek institucionet lokale



në Komunën e Dragashit dhe ia dolën që të caktojnë një prezantim të këtyre të gjeturave dhe rekomandimeve në sesionin e ardhshëm të Asamblesë Komunale në Dragash.

Shtojca I përmban një listë të të gjitha granteve të ndara nga Fondi i Grave të Kosovës në vitin 2015 dhe arritjeve të tyre deri në këtë datë.

Kapacitetet e stafit të RrGGK janë rritur

RrGGK, gjatë vitit 2015, ka vazhduar të ofrojë mundësi për anëtarët e stafit të saj, që të ngrisin kapacitetet e tyre:

1. Me 4-5 qershor, Nicole Farnsworth dhe Donjeta Morina morrën pjesë në punëtorinë dy-ditore mbi Indeksën e Barazisë Gjinore të BE-së, së bashku me institucionet e Kosovës. Pas një prezantimi të detajuar të Indeksit dhe metodologjisë së tij nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore, pjesëmarrësit diskutuan hapat e mëtejshëm për zhvillimin e Indeksit në Kosovë.
2. Me 5-9 tetor, Projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) në Kosovë mbajti trajnimin “Integrimi i perspektivës gjinore në zhvillimin e zingjirit të vlerës”, ku morri pjesë edhe Nertila Qarri – Gërguri, Koordinatorë e Projektit. Trajnimi ofroi mjete për përfshirjen e aspekteve gjinore në analizën e zinxhirëve të vlerave dhe në hartimin e strategjive gjinore që rrisin fuqizimin dhe të ardhurat për të gjitha grupet e interesit. Kjo do të forcojë aftësitë e RrGGK-së që të përkrahë anëtarët e saj në fuqizimin ekonomik të grave në të ardhmen.



3. Me 21-22 tetor, Donjeta Berisha, Koordinatore për Marrëdhënie me Publikun, mori pjesë në Forumin e Stokholmit për Internetin (SIF), një forum ndërkombëtar i cili promovon dialogun dhe diskutimet lidhur me mënyrën se si qasja e lirë, e hapur, dhe e sigurt në internet, promovon dhe forcon të drejtat e njeriut kudo në botë. Diskutimet ndërlidheshin me ekonominë, teknologjinë, politikat dhe të drejtat e njeriut, me një theks të veçantë në barazinë gjinore.
4. Në muajin nëntor të vitit 2015, Donjeta Morina, Koordinatore për Zhvillim të Kapaciteteve, mori pjesë në një punëtori një javore të organizuar nga Kvinna till Kvinna në Bruksel. Kjo punëtori ka përmirësuar aftësitë avokuese në nivel të BE-së. Ajo poashtu u takua me zyrtarë të ndryshëm në Bruksel për të avokuar për çështjet në Kosovë nga një perspektivë gjinore, përfshirë edhe përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim (DG NEAR), të Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS), dhe të Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian.
5. Adelina Berisha morri pjesë në një punëtori për Rehabilitimin dhe Ri-integrimin e të mbijetuarve të dhunës në familje, që u organizua nga OSBE-ja.
6. Shumica e anëtareve të stafit të RrGGK-së morrën pjesë në punëtorinë e RrGGK-së mbi përfshirjen e perspektives gjinore në dokumentet e politikave, si dhe kanë pranuar mentorim në ofrimin e komenteve në dokumentet e politikave para dhe pas trajnimit.
7. Ekipet përkatëse të hulumtimit të RrGGK-së kanë marrë pjesë në trajnime mbi kornizën ligjore për dhunën në familje, ngacmimet seksuale dhe ligjin e punës, si dhe mbi etikën e hulumtimit me qenie njerëzore.
8. Bazuar në përgjegjësitë e tyre, anëtarët e stafit të RrGGK kanë pranuar trajnim-gjatë-punës lidhur me: buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, analizën e buxhetit, aftësitë intervistuese, shkrimin e koncept



dokumenteve (concept notes), shkrimin e raporteve, monitorimin dhe vlerësimin, metodat e hulumtimit, përzgjedhjen e mostrës, aftësitë e të folurit publik, dhe ndarjen e dokumenteve në internet.

Është përmirësuar klima e financimit për organizatat për të drejtat e grave

Edhe pse disa iniciativat avokuese mund të merren edhe në baza vullnetare, OShC-të e udhëhequra nga gratë ende kanë nevojë për burime të ndryshme në shumë aspekte të punës së tyre të rëndësishme. Aktivizmi i qëndrueshëm për të drejtat e grave kërkon burime dhe RrGGK do të vazhdojë përpjekjet e saj në drejtim të mobilizimit të burimeve të mjaftueshme nga akterët vendor dhe ndërkombëtarë për mbështetjen e lëvizjes së grave në Kosovë dhe më gjerë.

Përmirësimi i vetëdijësimit institucional dhe publik për rëndësinë e zbritjeve tatimore për të mbështetur punën e rëndësishme të grupeve të të drejtave të grave

RrGGK do të punojë në këtë çështje në vitet e ardhshme.

Është zbatuar plani i RrGGK për ngritje të fondeve

RrGGK ka vazhduar ngritjen e fondeve në vitin 2015 dhe ka arritur që të sigurojë shumicën e burimeve të nevojshme për të bërë të mundur progresin në zbatimin e strategjisë këtë vit.



RRITJA E PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe vendimmarrje, në nivel komunal dhe qendror. RrGGK ka shënuar përparim drejt përmbushjes së kësaj objektive, siç paraqitet në arritjet dhe rezultatet e mëposhtme.

Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel komunal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore

Nëse gratë do të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror, numri i grave që marrin pjesë dhe cilësia e pjesëmarrjes së tyre duhet të rritet. Drejt arritjes së këtij qëllimi, 358 gra të ndryshme kanë marrë pjesë në politikë dhe procese vendimmarrëse përmes iniciativave të FGK.

Ndërkaq, 815 gra kanë marrë pjesë përmes iniciativave të Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë. Në vitin 2015, Lobi numëronte 949 anëtarë, nga 25 komuna të ndryshme. Gjatë vitit 2015, anëtarët e Lobit ndërmorrën 184 iniciativa të ndryshme avokuese, ku u përfshinë rreth 1345 gra dhe u arritën 13 ndryshime në politika. Në të njëjten kohë, cilësia e pjesëmarrjes është përmirësuar, gjë që është vërtetuar nga çështjet të cilat janë diskutuar në mes të grave dhe zyrtarëve përmes këtij veprimi. RrGGK ka kontribuar në këtë arritje përmes rezultateve të mëposhtme gjatë vitit 2015.



Grupet Avokuese për Barazi Gjinore (GABGJ) të themeluara dhe funksionale në 25 komuna dhe në nivel kombëtar

Me 21 nëntor 2014, 64 anëtare të GABGJ-ve mbajtën takimin e tyre të tretë në Strugë, Maqedoni. Gjatë këtij takimi, gra nga sfera e politikës dhe shoqërisë civile nga 17 komuna themeluan Lobin për Barazi Gjinore në Kosovë. Anëtarët vendosën që edhe burrat dhe djemtë që përkrahin të drejtat e barabarta për gra dhe burra, mund t'i bashkangjiten këtij grupi. Anëtarët e Lobit, sipas deklaratës së tyre “përkushtohen që të punojnë së bashku drejt arritjes së barazisë gjinore në Kosovë, pa marrë parasysh preferencat politike, gjininë, moshën, etnicitetin, aftësitë, fenë, pozitën gjeografike, nivelin e edukimit ose statusin shoqëror-ekonomik.” Momentalisht, grupet e Lobit ekzistojnë në 25 komuna.

Me 25 shkurt, 52 gra asambleiste, zyrtarë për barazi gjinore dhe përfaqësues të shoqërisë civile u mblodhën në Prishtinë për të diskutuar iniciativat e tyre të përbahskëta avokuese lidhur me të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës; Ligjin mbi Trashëgiminë; dhe aktivitetet avokuese të planifikuara për 8 Mars, Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Ato shkëmbyen informata, që i ndihmuan ato të finalizojnë idetë ekzistuese dhe të dalin me ide të reja.



Takimi i Lobit në Durrës, Shqipëri, 17-19 prill.

Më pas, me 8 Mars, anëtarët e Lobit i mënjanuan lulet dhe u fokusuan në avokim dhe ngritje të vetëdijes lidhur me të drejtat e grave, nëpër komunat e tyre. Ato theksuan që Dita Ndërkombëtare e Gruas ka të bëjë me përpjekjet historike dhe të vazhdueshme për të drejta të grave në Kosovë dhe më gjërë. Ato organizuan një numër ngjarjesh nëpër komuna të ndryshme, duke përfshirë: shfaqjen e filmit *Iron Jawed Angels* (Engjujt e Hekurt), një film që tregon rrugëtimin dhe sfidat e grave për të fituar të drejtën e votës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; vizitat që i'u janë bërë grave në burgun e Lipjanit; marshimet dhe protestat në nivel komunal për çështje të ndryshme që lidhen me të drejtat e grave; dhe takimet me institucionet drejt përmirësimit të shërbimeve për gratë.

Me 17-19 prill, 94 gra përfaqësuese të sferës politike dhe asaj të shoqërisë civile, nga 23 komuna të ndryshme të Kosovës, u mbledhën për një takim tre ditorë të Lobit në Durrës, Shqipëri. Anëtarët u ndanë në grupe sipas komunave, duke u përcaktuar në tre çështje në nivel lokal dhe një çështje në nivel kombëtarë për të cilat do të avokojnë së bashku gjatë vitit 2015. Ato gjithashtu u informuan rreth Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, nga Jeta Krasniqi, Këshilltare Politike e Presidentes së Republikës së Kosovës; dhe shikuan filmin “Tri dritare dhe një varrje” dhe dokumentarin “Lëvizja e Gruas Shqiptare” i cili është punuar për 20 vjetorin e lëvizjes së grave në Shqipëri. Eglantina Gjermani, Ministre e Zhvillimit Urban në Republikën e Shqipërisë foli për karrierën e saj duke filluar nga përvoja e saj në shoqërinë civile e deri tek jeta e saj aktuale në politikë.

Për ta bërë të mundur këtë takim anëtarët e Lobit kanë kontribuar 920 euro.

Me 28 maj, 250 pjesëmarrës, përfshirë këtu anëtarët e Lobit dhe RrGGK, familjare të dëshmorëve të Komunës së Dragashit, donatorë, miq dhe përkrahës të RrGGK-së, morrën pjesë në një takim të



përbashkët. Pjesëmarrëset i dorëzuan Presidentes Jahjaga fustanat dhe fundet që i kishin mbledhë për të kontribuar në instalacionin artistik “Mendoj për ty” të artistes Alketa Xhafa-Mripa. Instalacioni iu dedikua grave që kanë mbijetuar dhunën seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe ishte organizuar nga Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, i themeluar dhe i udhëhequr nga Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga. Gjatë pjesës së dytë të takimit, anëtarët e Lobit dhe RrGGK-së diskutuan iniciativat e tyre avokuese.

Zhvillimi i kapaciteteve të grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave

Takimet e lartëpërmendura të Lobit poashtu zhvilluan edhe më shumë kapacitetet e grave në politikë që të avokojnë për prioritetet e grave duke ofruar shembuj të praktikave më të mira dhe duke i përmirësuar aftësitë e tyre avokuese. Gjatë vitit 2015, anëtarët e Lobit në 25 komuna të Kosovës, kanë mbajtur 221 takime në mes të në mes të grave qytetare dhe atyre në vendimmarrje, me ç’rast avokuan për çështje të rëndësishme për gratë. Ato përfituan njohuri lidhur me atë se çka është BPGJ; si ta përfshijnë atë në dokumentet e buxhetit (në nivel lokal dhe qendror); dhe njohuri lidhur me kornizën e re ligjore mbi BPGJ. RrGGK ka ofruar mentorim të vazhdueshëm për gratë në politikë, duke i përkrahur ato në përpjekjet e tyre avokuese.

Për më shumë, RrGGK u takua me gra dhe burra që janë zyrtarë për barazi gjinore në nivel komunal dhe ministror, dhe përfaqësues të linjës ministrorë, duke i përkrahur ata në përfshirjen e perspektives gjinore në Dokumentet e Planifikimit Sektorial dhe Dokumentet e Veprimit të cilat ata ishin duke i planifikuar për Instrumentin e BE-së për Ndihmë Para-anëtarësimit (IPA). RrGGK ka përkrahur përfshirjen e perspektivës



gjinore në pesë Dokumente të Planifikimit Sektorial dhe 15 Dokumente të Veprimit. Kjo përfshinte trajnim-gjatë-punës për 24 gra dhe 12 burra nga sfera e politikës lidhur me atë se si të përfshijnë perspektiven gjinore në këto dokumente, duke u siguruar në këtë mënyrë që prioritetet dhe nevojat e grave janë marrë parasysh mjaftueshëm.

RrGGK poashtu ka ofruar trajnim dhe mentorim për tre zyrtarë për barazi gjinore nëpër ministri lidhur me atë se si të përfshihet perspektiva gjinore në dokumentet IPA, veçanërisht Kornizat Logjike, si dhe i ka përkrahur ata në avokim që nevojat e grave të mirren parasysh në këto dokumente. Kjo është përkrahur financiarisht nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

RrGGK gjithashtu ka ofruar trajnim për zyrtarët për barazi gjinore nga ministrinë dhe komunat lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe se si ta zbatojnë atë në punën e tyre. Kjo përfshinte shembuj praktik në ri-shikimin e projektbuxheteve të institucioneve të tyre përkatëse dhe përgatitjen e komenteve nga një perspektivë gjinore në këto dokumente

Me 21 shtator, RrGGK organizoi një trajnim lidhur me atë se si të bëhet përfshirja e perspektivës gjinore në politikat publike, ku morrën pjesë anëtarë të RrGGK, si dhe tetë pjesëtarë të asambleve komunale nga Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë. Pas një prezantimi të shkurtër mbi strategjitë për përfshirjen e perspektivës gjinore në politika publike, RrGGK shpërndau disa politika të rëndësishme për gratë dhe grupet punuese bashkëpunuan në komentimin e këtyre politikave nga një perspektivë gjinore.

RrGGK ka bashkëpunuar me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), Agjencinë për Barazi Gjinore, dhe Programin për Reformë Ligjore të GIZ-it për të organizuar takime me gra dhe burra nga sfera politike në shtatë komuna (Gjakovë, Skënderaj, Drenas, Deçan, Pejë, Rahovec dhe Mamushë). RrGGK



prezantoi shkurtë kornizën e re ligjore për barazi gjinore dhe diskutoi sfidat me të cilat zyrtarët janë përballur gjatë zbatimit të kornizës ligjore deri më sot, drejt zgjidhjes së problemeve dhe adresimit të tyre. Shembuj nga këto përvoja (si dhe nga komuna e ministri të tjera) do të përdoren për të nxjerrë informata për raste studimore dhe për të dizajnuar kurrikulën e re të IKAP-it për barazi gjinore, në vitin 2016. Kurrikula e re e IKAP-it për shërbyesit civil, respektivisht për zyrtarët për barazi gjinore, do të përmirësojë kapacitetet e grave dhe të burrave, lidhur me atë se si të marrin parasysh prioritetet e grave në të ardhmen.

Iniciativat e ndërmarra nga katër organizata anëtare të RrGGK-së të përkrahura nga Fondi i Grave të Kosovës këtë vit, kanë përfshirë 317 gra në procese vendimmarrëse (takime me autoritetet në nivel lokal, avokim). Për disa nga këto gra, kjo ishte hera e parë që ato janë përfshirë në një proces vendimmarrës.

Vetëdijësim i rritur për rëndësinë e përafrimit të Ligjit për Barazi Gjinore dhe ligjeve zgjedhore

Si anëtare zyrtare e grupit punues qeveritar për hartimin e Ligjit për Barazi Gjinore, [Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës \(RrGGK\)](#) ka pasur mundësinë të ofroj komente dhe sugjerime në disa versione të projekt ligjit. Procesi i cili ka filluar në fund të vitit 2015 ka përfunduar me përfshirjen e ndryshimeve. Prej më shumë se 20 komente që RrGGK ka bërë për projekt ligjin e fundit, shtatë prej tyre janë adoptuar në Ligjin e ri për Barazi Gjinore (Nr. 05/L -020) i cili, u miratua me 28 maj 2015. Ndër komentet e marra parasysh në Ligj bëjnë pjesë:

- Neni 5.1.8: Të gjitha institucionet duhet të mbledhin të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe t'i dorëzojnë ato në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.



- Nenet 8.1.9 dhe 8.12: Analizat e statusit të barazisë gjinore në Kosovë, së bashku me një raport mbi zbatimin e ligjit, duhet të publikohen dhe të vihen në dispozicion të publikut.
- RrGGK dhe palët e tjera të interesit siç janë Agjencia për Barazi Gjinore dhe GIZ, kanë avokuar me sukses që Ligji t'iu kërkojë të gjitha institucioneve të Kosovës përfshirjen e buxhetimit gjinor.

Për informata të mëtejshme, ju lutemi lexoni: ["Ligji i ri i Kosovës për Barazi Gjinore "Të mirat, të fqijat, të diskutueshme."](#)

Gjatë takimeve të grupit punes dhe në avokimet përcjellëse, RrGGK ka theksuar rëndësinë e përafrimit të këtij Ligji të ri me ligjet zgjedhore, që do të nënkuptonte që të kërkohet pjesëmarrja e grave dhe burrave në 50% në të gjitha nivelet vendimmarrëse.

Komunikim dhe bashkëpunim i shtuar për prioritetet e tyre, në mes të grave në politikë, organizatave të grave dhe grave votuese

Përmes anëtareve të Lobit dhe RrGGK-së, gratë nga sfera politike, shoqëria civile dhe gratë votuese kanë bashkëpunuar rreth çështjeve të rëndësishme për to gjatë vitit 2015. Kjo përfshinte çështje lidhur me përkrahjen publike dhe pagesën e pensione ve për gratë që kanë mbijetuar dhunën seksuale gjatë luftës; rritjen e vetëdijes së grave lidhur me të drejtat e tyre në trashëgimi dhe pronë; dhe një numër çështjesh të tjera në nivel lokal.



Avokimi i iniciuar për çështjet që gratë i konsiderojnë prioritet

Në vitin 2015, RrGGK ka vënë rekord sa i përket numrit të proceseve politike dhe politikave në të cilat RrGGK ka avokuar për prioritetet e grave. RrGGK ka marrë pjesë në një numër të grupeve punuese qeveritare dhe/ose ka ofruar komente në ligjet dhe politikat që do të ndikojnë në jetët e grave dhe vajzave. RrGGK ka përkrahur përfshirjen e perspektives gjinore, duke analizuar draftet e politikave publike (ligjeve, udhëzimeve administrative, strategjive, planeve të veprimit) nga një perspektivë gjinore dhe duke vlerësuar ndikimin potencial që ato mund të kenë në burra, gra, vajza dhe djem. Në vitin 2015, politikat të cilat RrGGK i ka ri-shikuar nga një perspektivë gjinore dhe/ose ka ofruar të dhëna përfshinin:

1. Projektligjin mbi Barazinë Gjinore, Ligji Nr. 05/L-020
2. Projektligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligji Nr. 05/L-21
3. Projektligji për Avokatin e Popullit, Ligji Nr. 05/L-19
4. Projektligji për Inspektoratin Shëndetësor
5. Projektligji për regjistrimin, shërbimet dhe masat për punësimin e të papunëve, punëkërkesve, dhe të punëdhënësve
6. Projektligji për Ndërmarrjet Sociale
7. Projektligji i Punës
8. Drafti i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
9. Drafti i Strategjisë për të Drejta të Njeriut
10. Drafti i Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje

11. Diskutime lidhur me draftin e ri të Kodit Civil, përfshirë ligjin për familjen, ligjin për trashëgiminë dhe të drejtat e pronës
12. Udhëzimi Administrativ për Regjistrimin e Pronës në emër të Bashkëshortëve
13. Rregullorja për Procedurat e Njohjes dhe Verifikimit të Statutit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë, që përfshinë mekanizmat dhe formularët përkatës
14. Qarkorja Buxhetore 2015/01
15. Qarkorja Buxhetore për organizatat e nivelit qendror 2016/02
16. Qarkorja Buxhetore për organizatat e nivelit lokal 2016/02
17. Kapitulli i Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Kamenicës
18. Buxheti për vitin 2016 i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
19. Drafti i Strategjisë mbi Zhvillimin e Kapaciteteve Hulumtuese në Universitetin e Prishtinës
20. Drafti i Planit të Veprimit për Barazi Gjinore i BE-së (Bruksel)
21. Drafti i Indikatorëve të BE-së për Qasje Gjithëpërfshirëse drejt Implementimit të RKSKB I 325 dhe I 820 nga BE (Bruksel)
22. Ri-shikimi i Strategjisë së Sigurisë për BE dhe Misionet e ESDP-së (Bruksel)
23. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 2242 (New York)

RrGGK më pas ka avokuar që zyrtarët të pranojnë pikat shtesë të RrGGK-së, drejt reflektimit më të mirë të prioriteve dhe nevojave të grave nëpër politika publike.



Përveç pjesëmarrjes në këto procese të politikave, RrGGK ka avokuar për disa çështje të tjera të rëndësishme për gra. Këto përfshinin:

24. Zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore në nivele të ndryshme
25. Vëmendjen për nevojat e grave të pa-martuara mbi regjistrimin e pronës
26. Institucionalizimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)
27. Institucionalizimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
28. Institucionalizimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Komunën e Kamenicës
29. Institucionalizimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Komunën e Gjakovës
30. Krijimin e një pozite të përhershme të zyrtarit për barazi gjinore nga Ministria e Integritimit Evropian
31. Që Ministria e Integritimit Evropian të sigurohet se të gjitha politikat dhe ligjet e miratuara në përputhje me procesin e Anëtarësimit të Kosovës në BE përfshijnë perspektivën gjinore
32. Kundër dhunës në familje dhe për zbatimin nga të gjitha institucionet përkatëse të kornizës ligjore që ka të bëjë me dhunën në familje
33. Që Ministria e Financave të ndajë një buxhet të mjaftueshëm për gratë që kanë vuajtur dhunë gjatë luftës dhe që një Këshill ndër-ministrior i përhershëm t'i ndihmojë gratë.
34. Që buxheti i Kosovës për vitin 2016 të përfshijë interesat e grave (shih letrën zyrtare)
35. Që Raporti i Progresit të përfshijë edhe më gjërësisht perspektivën gjinore

36. Për mbrojtjen e grave dhe familjeve nga komunitetet ku po vazhdojnë hetimet forenzike, përfshirë edhe ato që lidhen me personat e zhdukur

37. Kundër dhunës në baza gjinore

RrGGK në bashkëpunim me Lobin për Barazi Gjinore filloi fushatën “Unë guxoj” për të ngritur vetëdijen lidhur me kornizën ligjore që mbron gratë dhe vajzat. “Unë guxoj” është një shfaqje që përmban pesë monologje që trajtojnë çështjet e dhunimeve gjatë luftës, dhunës në familje, ngacmimeve seksuale në punë, dhe të drejtat e grave për të trashëguar pronë. Monologjet përfundojnë me mesazhe pozitive, duke i fuqizuar vajzat dhe gratë për të realizuar të drejtat e tyre dhe për të përdorur kornizën ligjore në fuqi. “Unë guxoj” është shfaqur në Dragash, Rogovë, Lipjan, Drenas, Viti, Prizren, Kaçanik, Han të Elezit, Deçan dhe Gjilan, ku morrën pjesë më shumë se 1200 persona. Aktoret janë Kumrie Hoxha, Makfire Miftari, Florentina Ademi, Safete Rogova dhe Molika Maxhuni. Kjo fushatë është përkrahur nga Ambasada e Hollandës.

Përmes Fondit të Grave të Kosovës, RrGGK gjithashtu ka përkrahur gjashtë iniciativa avokuese të anëtareve të RrGGK, të detajizuara në pjesën paraprake të këtij raporti.

Drejt këtij rezultati, RrGGK poashtu ka dërguar tri letra avokuese tek zyrtarët, gjatë këtij viti:

- 1) Letër drejtuar z. Isa Mustafa, Kryeministër i Republikës së Kosovës lidhur me protestat (29 janar)
- 2) Letër e hapur: RrGGK shpreh shqetësimin e thellë lidhur me ri-traumatizimin e pamëshirshëm të banorëve të Krushës së Vogël, në radhë të parë të grave, nga ana e EULEX-it (27 gusht)
- 3) Deklaratë e shoqërisë civile pas dështimit të anëtarësimit të Kosovës në UNESCO Kërkojmë Rishikim të Pozicionit në Dialog dhe Përgjegjësi Politike (11 nëntor)



Përmirësimi i institutucionalizimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në Kosovë

Buxheti i përgjegjshëm gjinor është i rëndësishëm jo vetëm për rritjen dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, por edhe për ndarjen efikase dhe të barabartë të fondeve publike. Prandaj, RrGGK, është duke u bazuar në përvojat pozitive të kaluara, duke përdorur metodën e zhvilluar nga GIZ dhe ekspertizën ndërkombëtare, që të punojë drejtë institutucionalizimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ) në Kosovë.

Përmirësimi i kapaciteteve të zyrtarëve të synuar për kryerjen e BPGJ

Në total 134 zyrtarë, shërbyes civil dhe studentë janë trajnuar në vitin 2015, duke e ngritur numrin total të njerëzve të trajnuar nga RrGGK për BPGJ-në, në 153. Personat e trajnuar përfshinin zyrtarë të financave, udhëheqës të financave në drejtorate komunale, përfaqësues të departamenteve dhe divizioneve ministrorë, si dhe Zyrtarë për Barazi Gjinore (ZBGJ). Për më tepër, 33 persona kanë pranuar mentorim mbi BPGJ-në, duke e ngritur numrin total të personave që kane pranuar mentorim nga RrGGK në 60. Kapacitete të ndryshme të zyrtarëve janë përmirësuar dukshëm, siç është vërejtur në shkallën në të cilën Gjakova, Kamenica dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e kanë përfshirë analizën gjinore në dokumentet e tyre buxhetore të vitit 2016.



Rekomandime konkrete për përmirësimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor janë prezantuar tek zyrtarët përkatës me qëllim të institucionalizimit të BPGJ

Në vitin 2015, RrGGK ka qenë dëshmitare e disa momenteve shumë të rëndësishme dhe sukseseve sa i përket BPGJ-së. Si rrjedhojë e avokimit dhe monitorimit të RrGGK-së, këtë vit, në politika dhe dokumente kanë ndodhur ndryshimet në vijim:

- Ministria e Financave ka përfshirë referenca, paragrafe dhe tabela specifike në Qarkoren e saj Buxhetore 2016/2 për **organizatat Qendrore të buxhetit**. Organizatat Qendrore të Buxhetit janë inkurajuar që të përfshijnë BPGJ-në në dokumentet e tyre buxhetore.
- Ministria e Financave në mënyrë të njëjtë ka përfshirë referenca, paragrafe dhe tabela specifike në Qarkoren e saj Buxhetore 2016/02 për **organizatat Lokale të buxhetit**.
- Komuna e Kamenicës ka integruar BPGJ-në në **Kornizën Afatmesme Buxhetore të saj**, dhe ka dokumentin më të përgjegjshëm gjinor në mesin e të gjitha komunave në Republikën e Kosovës.
- Që nga muaji korrik i vitit 2015, BPGJ-ja është një obligim ligjor, pasi që avokimi i RrGGK-së ka kontribuar që ajo të bëhet pjesë e **Ligjit të Ri për Barazi Gjinore 05/L-020**.
- Komuna e Kamenicës e ka integruar BPGJ-në në **dokumentin e buxhetit vjetor të saj për vitin 2016, duke** u bërë kështu njëra ndër komunat e para në Kosovë që i ka përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë si shtojcë në buxhetin e saj vjetor.



- Komuna e Gjakovës e ka integruar BPGJ-në në **dokumentin e buxhetit vjetor të saj për vitin 2016**, duke u bërë kështu njëra ndër komunat e para në Kosovë që i ka përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë si shtojcë në buxhetin e saj vjetor.
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i ka përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë në **buxhetin vjetor** të saj, të cilin ia ka dërguar Ministrisë së Financave.

RrGGK poashtu ka publikuar raportin hulumtues *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale* mbi përgjegjësinë gjinore të shërbimeve dhe shpenzimeve të MPMS-së në dy kategori ekonomike: paga dhe mëditje, dhe subvencione dhe transfere. Raporti përfshinë disa rekomandime që kanë për synim të përkrahin MPMS-në në planifikimin e shpenzimeve afat-mesme në një mënyrë më të ndjeshme me perspektivë gjinore. Për të lexuar raportin e plotë, klikoni [këtu](#).



RrGGK ka publikuar raportin Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale mbi përgjegjësinë gjinore të shërbimeve të MPMS-së.

PËRMIRËSIMI I QASJES SË GRAVE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR CILËSOR

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që “gratë të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor dhe me kosto të përballueshme.” RrGGK ende nuk ka mundur të sigurojë financim për këtë program. Por, prapë se prapë, falë anëtareve të RrGGK-së, përfshirë edhe ato që janë përkrahur nga Fondi i Grave të Kosovës, ka pasur pak progres në këtë drejtim.

Zyrtarët publik dhe institucionet shëndetësore të jenë më përgjegjëse në adresimin e shkeljes së të drejtave të grave për kujdes shëndetësor

RrGGK i ka dërguar letër zyrtare Institutit Gjinekologjik duke kërkuar kujdes më të mirë shëndetësor për nënat që i lindin fëmijët aty. RrGGK ka avokuar që të mos ndërtohet burgu në spital, por që të ketë një spital të veçantë për personat e burgosur në Kosovë, me staf profesional që do të përputhej me standartet ndërkombëtare, si për anën profesionale, ashtu edhe për atë shëndetësore të ofrimit të shërbimeve. Letra poashtu ka kërkuar që buxheti gjinor të zbatohet në vitin 2016.

RrGGK poashtu ka marrë parasysht kërkesat shëndetësore të grave gjatë shtatëzanisë dhe pas lindjes së fëmijës, si pjesë e dokumentit punues të RrGGK-së mbi Ligjin e Punës (shih më poshtë), duke përfshirë rekomandimin për pushim të mjaftueshëm me pagesë për kryerjen e analizave mjekësore. RrGGK planifikon të punojë më shumë drejt arritjes së këtij qëllimi në vitet e ardhshme.



Më shumë gra dhe vajza të vetëdijësuara për të drejtat e tyre dhe për rëndësinë e qasjes në kujdes shëndetësor; më shumë gra të vetëdijësuara si të zbulojnë shenjat e kancerit

Shoqata Iniciativa e Grave, e përkrahur nga Fondi i Grave të Kosovës është duke punuar në përmirësimin e qasjes së grave në kujdes shëndetësor në Komunën e Dragashit duke realizuar një hulumtim të gjeturat e të cilit i'u prezentuan zyrtarëve publik dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve shëndetësore në Komunën e Dragashit. Hulumtimi ka treguar se vetëm 15.29% e respondentëve kishin njohuri për ligjin No. 04/L-125 mbi shëndetin. Kur u pyetën se çka do të ndryshonin në sistemin e shëndetësisë, respondentët i dhanë prioritet faktit që institucionet shëndetësore duhet të kenë furnizim të rregullt me medikamente mjekësore, standarte më të larta të higjienës, të punësojnë gra mjeke, të kenë kujdes shëndetësor etj.

Poashtu, e përkrahur nga Fondi, Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave sapo ka filluar një iniciativë për ngritjen e vetëdijes për të drejtat e grave për qasje në kujdes shëndetësor. Ato janë duke avokuar që se paku 80 gra nga katër fshatra të Drenasit të kryejnë kontrolle gjinekologjike falas.

Të ketë hulumtim për dokumentimin e shkëljes së të drejtave të grave në kujdes shëndetësor

RrGGK ka krijuar metodologjinë e hulumtimit dhe instrumentet e anketimit që do të përdoren për të kryer këtë hulumtim në vitin 2016. Anketimi u pilotua në Komunën e Dragashit nga Shoqata Iniciativa e Grave, këtë vit. Ato anketuan 170 respondentë të përzgjedhur rastësisht në Dragash, shumica gra.

Shoqata Iniciativa e Grave për herë të parë ka kryer një hulumtim mbi çështjet e shëndetit të grave në Dragash,



me 170 respondentë. Hulumtimi ka treguar se vetëm 15.29% e respondentëve kanë njohuri për Ligjin No. 04/L-125 mbi shëndetin. Kur u pyetën se çka do të ndryshonin në sistemin e shëndetësisë, respondentët i dhanë prioritet faktit që institucionet shëndetësore duhet të kenë furnizim të rregullt me medikamente mjekësore, standarte më të larta të higjienës, të punësojnë gra mjeke, të kenë kujdes shëndetësor etj. RrGGK po provon gjej fonde për të realizuar një hulumtim, trajnim dhe të përfshijë anëtarët e saj në dokumentimin e shkeljeve të të drejtave në vitin 2016, një iniciativë që do të kryhet në bashkëpunim me Dartmouth College.

Më shumë zyrtarë publik, gra, vajza dhe burra janë në dijeni për të drejtën e grave për kujdes shëndetësor dhe shkeljet e të drejtave të tyre

Shoqata Iniciativa e Grave planifikon të mbledhë zyrtarët nga institucionet shëndetësore publike dhe Komuna e Dragashit për të diskutuar të dhënat e dala nga hulumtimi i lartëpërmendur.

Më tepër gra të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor

RrGGK do të punojë në këtë fushë në vitet e ardhshme, edhe pse disa anëtare të RrGGK kanë ndërmarrë disa iniciativa.



Gratë dhe vajzat më të vetëdijshme për të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor dhe për rëndësinë e qasjes në kujdesin shëndetësor

Më 17 tetor, Jeta-Vita, Qendra për Luftimin e Kancerit të Gjirit, organizoi programin e tyre tashmë vjetor, kulturor dhe informues, ku qytetarët kanë marshuar së bashku me moton e organizatës: “Zbulimi i Hershëm do të thotë Jetë”, për të shprehur solidaritetin dhe për të rritur sensibilizimin për kancerin e gjirit në shoqërinë kosovare. Programi është organizuar nën patronatin e Presidentes së Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga. Programi ka mbledhur bashkë qindra qytetarë, duke përfshirë pjesëtarët e stafit të RrGGK-së dhe përfaqësues të OJQ-ve të tjera, si dhe përfaqësues të niveleve të larta shtetërore. Jeta-Vita ka organizuar edhe aktivitete shtesë gjatë muajit për sensibilizimin e qytetarëve për kancerin e gjirit.

Më shumë gra avokojnë për të drejtat e tyre për kujdes shëndetësor cilësor

RrGGK do të punojë në këtë fushë në vitet e ardhshme.



JETA PA DHUNË NË BAZA GJINORE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë dhe vajzat të jetojnë një jetë të lirë nga dhuna në baza gjinore. RrGGK ka bërë progres drejt përmbushjes së këtij qëllimi, siç e ilustrojnë edhe të arriturat dhe rezultatet në vazhdim. Këtë vit, RrGGK u fokusua në vendosjen e një baze të qartë për realizimin e hulumtimit shumë të rendësishëm mbi dhunën në familje, respektivisht mbi ngacmimet seksuale. Në fund të vitit, RrGGK poashtu ka filluar përpjekjet avokuese për zbatimin e rekomandimeve që kanë dalë nga ky hulumtim. RrGGK do të vazhdojë avokimin në vitin 2016, duke i matur ndryshimet që paraqiten në vitin 2017.

Zbatimi i kornizës ligjore të dhunës në familje, duke përfshirë përgjigjet institucionale në ndihmën ndaj personave që kanë pësuar dhunë, është përmirësuar

RrGGK do të punojë në këtë fushë në vitet e ardhshme, bazuar në të dhënat e dala nga hulumtimi i vitit 2015.



Raportet e monitorimit ekzistojnë në zbatimin e kornizës ligjore të dhunës në familje, si dhe ndërgjegjësimin rreth kornizës ligjor dhe shtrirjen e dhunës në familje

RrGGK ka anketuar 1,315 kosovarë (51.6% gra e 48.4% burra) për të matur vetëdijësimin, qëndrimet dhe incidencën e dhunës në familje; dhe ka kryer intervista me 200 përfaqësues të institucioneve publike dhe të organizatave të shoqërisë civile përgjegjëse për zbatimin e kornizës ligjore që ka të bëjë me dhunën në familje. Në nëntor, RrGGK publikoi një raport gjithëpërfshirës mbi dhunën në familje në Kosovë, të titulluar *Mjaft më me arsyetime: Një Analizë e Qëndrimeve, Incidencës dhe Përgjigjes Institucionale ndaj Dhunës në Familje në Kosovë*. Ai përfshinë një ri-shikim të zbatimit të kornizës ligjore deri më sot. Ky është raporti i dytë hulumtues, pas atij të vitit 2008 të titulluar *Siguria fillon në shtëpi*, dhe vlerëson ndryshimet që kanë ndodhur që atëherë. Hulumtimi ka dalë në përfundim që 62% e kosovarëve kanë përjetuar një formë të dhunës në familje në një moment të jetës së tyre. Në vitin 2014, 31% e kosovarëve kanë përjetuar dhunë në familje.



Institucionet dhe akterët e tjerë janë të vetëdijshëm për shkallën në të cilën është zbatuar kuadri ligjor për dhunën në familje

Mjaft më me arsye u publikua me 23 nëntor, në kuadër të Grupit Punues zyrtarë qeveritarë që është duke e hartuar Strategjinë e re Kombëtare kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit për periudhën 2016-2020. Përfaqësues të ndryshëm të institucioneve kyçe dhe akterë të tjerë morrën pjesë në publikim. RrGGK poashtu ka krijuar katër përmbledhje faktesh me rekomandime specifike për Grupin Punues që t'i kenë parasyshë lidhur me secilën nga tri objektivat e strategjisë së re, si dhe rekomandimet e përgjithshme për Strategjinë. Në vitin 2016, RrGGK do të vazhdojë të ngrisë vetëdijen e institucioneve lidhur me atë se sa është zbatuar korniza ligjore.

RrGGK është ftuar nga Projekti i Binjakëzimit të BE-së “Programi Parandalues” që të trajnojë zyrtarët nga Shërbimet Korrektuese dhe Sprovues në Kosovë. RrGGK ka ofruar pesë sesione trajnuese për 88 punëtorë socialë, zyrtarë sprovues dhe përfaqësues të tjerë nga këto institucione lidhur me konceptet bazë të barazisë gjinore; obligimet ligjore që ata i kanë lidhur me dhunën në familje; të gjeturat kryesore nga *Mjaft më me arsye*; trajtimin e kryerësve të veprave të dhunës; dhe rëndësinë e bashkëpunimit me shoqërinë civile, veçanërisht me strehimoret. Trajnimi u fokusua në përgjegjësitë që i ka secili institucion në ofrimin e një trajtimi të tillë dhe strategjitë për ofrimin e këtyre shërbimeve. Pjesëmarrësit ishin të kënaqur me trajnimin, duke theksuar që kjo ishte hera e parë që e diskutonin specifikisht dhunën në familje dhe dhunën seksuale.

Pjesëtarja e stafit të RrGGK Nicole Farnsworth dhe Kryetarja e Bordit Ariana Qosaj-Mustafa poashtu ofruan trajnim për përfqësuesit e qendrave rajonale të punësimit dhe për qendrat e aftësimi



profesional mbi rolin e tyre në të ndihmuarit e rehabilitimit të personave që kanë përjetuar dhunë në familje. Kjo përfshinte përgjegjësitë e tyre ligjore dhe çasjen e duhur për t'i ndihmuar personat që kanë përjetuar dhunë në baza gjinore, të cilët ka mundësi që vuajnë nga traumat. Kjo u përkrah financiarisht nga United Nations Development Programme, veçmas nga aktivitetet zyrtare të RrGGK.

Anëtares e RrGGK janë angazhuar për zbatimin e kornizës ligjore për dhunën në familje

Bazuar në të gjeturat e hulumtimit, RrGGK ka organizuar diskutime fillestare me dy organizata anëtare të RrGGK për të filluar hartimin e strategjisë për avokim dhe ngritje të vetëdijes për vitin 2016. RrGGK do të mundohet të përfshijë më shumë anëtare në këtë avokim, duke filluar nga viti i ardhshëm. Për më tepër, 15 anëtare të RrGGK-së u përfshinë në 25 inicativa avokuese për zbatimin e kornizës ligjore nëpër komunat e tyre, veçanërisht gjatë 16 Ditëve kundër Dhunës ndaj Grave. Disa anëtare të RrGGK-së poashtu u përfshinë në mekanizmat koordinues komunal për adresimin e dhunës në familje, në përputhje me kornizën ligjore.

Performanca dhe cilësia e shërbimeve të strehimoreve është ngritur, veçanërisht në drejtim të rehabilitimit dhe ri-integritit

RrGGK ka vazhduar të avokojë për financim të qëndrueshëm për strehimoret si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal, si dhe për përmirësim të monitorimit të cilësisë së shërbimeve. Kjo u përfshi përmes



rekomandimeve specifike të bëra për MPMS-në në raportin e ri të RrGGK-së, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale (2015)*. RrGGK, në vitin 2014, bazuar në raportin e saj paraprak, ka rekomanduar që strehimoret duhet të kompenzohen për kokë personi të strehuar, gjë që është zbatuar nga Ministria në fillim të vitit 2015. Procesi i licensimit të punëtorëve social dhe strehimoreve pothuajse është kompletuar nga Ministria këtë vit. Tani RrGGK po avokon për monitorim të vazhdueshëm në vitet e ardhshme.

Ndërgjegjësimi dhe vëmendja në trajtimin e dhunës në baza gjinore në mesin e zyrtarëve dhe qytetarëve është përmirësuar, duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual

Bazuar në të gjeturat e hulumtimit, RrGGK do të punojë më shumë në ngritjen e vetëdijes gjatë vitit 2016.

Më shumë qytetarë të informuar në lidhje me kornizën ligjore dhe të drejtat e tyre, duke përfshirë meshkujt

Për gratë dhe vajzat në Kosovë, ngacmimi seksual mbetet një shqetësim i madh sa i përket sigurisë dhe mirëqenies së tyre. Në fund të vitit 2014, RrGGK organizoi një fushatë që kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes për ngacmimet seksuale. *“Take Back the Night”* përfshiu qytetarët në shprehjen e shqetësimeve të tyre lidhur me ngacmimet seksuale, duke përdorur mediat sociale dhe demonstrimin publik. Në vitin 2015, RrGGK ka kryer hulumtimin e parë në mbarë Kosovën për format e ndryshme të ngacmimeve seksuale në lokacione të ndryshme për të identifikuar incidencën, si dhe vetëdijesimin dhe qëndrimet e



qytetarëve ndaj ngacmimit seksual. Kjo përfshiu anketimin e 1,315 grave dhe burrave, si dhe intervistat me përfaqësuesit e rreth 200 institucioneve. RrGGK po finalizon raportin, i cili do të publikohet në fillim të vitit 2016. Ai do të shërbejë si bazë për një fushatë vetëdijësuese për këtë temë.

Anëtarët e RrGGK-së poashtu kanë qenë aktive, Për shembull, Artpolis dhe organizata Femrat Aktive të Gjakovës me anë të një Granti në Partneritet për Ndryshim, të përkrahura nga Fondi i Grave të Kosovës, kanë filluar një iniciativë për të adresuar ngacmimet seksuale në universitetet publike të Prishtinës dhe Gjakovës, duke avokuar për krijimin e mekanizmave nëpër këto institucione. Kjo ka përfshirë ngritjen e vetëdijes në mes të studentëve lidhur me të drejtat e tyre ligjore. Puna e tyre po vazhdon.

Politikat dhe procedurat e përmirësuara për trajtimin e ngacmimit seksual ekzistojnë

RrGGK po vazhdon të bashkëpunojë me anëtarët e saj në avokimin për këtë çështje duke filluar nga viti 2016, bazuar në rekomandimet e dala nga hulumtimi që do të publikohet në fillim të vitit 2016.



Koordinimi i themeluar në mesin e OSHC-ve të udhëhequra nga gratë, institucioneve publike, si dhe vendeve të tjera të punës në drejtim të instalimit të mekanizmave të përmirësuar për raportimin dhe hetimin e rasteve të ngacmimit seksual

Siç u përmend, Artpolis dhe organizata Femrat Aktive të Gjakovës do të bashkëpunojnë me Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin e Gjakovës për të krijuar politika kundër ngacmimeve seksuale, duke përfshirë edhe përmirësimin e mekanizmave të raportimit. RrGGK planifikon të ndër marrë hapa të mëtutjeshëm drejt këtij rezultati në vitin 2016, bazuar në hulumtim.

Mbështetja institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës është përmirësuar

Në një zhvillim thelbësorë, me 7 mars, Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga, themloi Këshillin Kombëtarë për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, në të cilin RrGGK-ja është anëtare. Këshilli mbledhë përfaqësuesit e ministrive kyçe të cilat mund t'i përkrahin të mbijetuarit e dhunës, shoqërinë civile, dhe akterët ndërkombëtarë, drejt një përgjigjeje të përmirësuar dhe të koordinuar më mirë. Këshilli u themelua për t'iu përgjigjur shqetësimeve dhe çështjeve të ngritura nga gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale, pas diskutimeve në mes të Presidentes Jahjaga dhe grave, përkrahur nga RrGGK në vitet e kaluara. RrGGK i ka përkrahur gratë që i kanë mbijetuar dhunës seksuale gjatë luftës në avokim tek institucionet që nevojat e këtyre grave të adresohen më mirë. Tani, RrGGK po avokon për Këshillin që të ketë buxhet dhe mandat të përhershëm, si dhe për fonde të përhershme për të mbijetuarit.



Përfshirja e RrGGK dhe e anëtareve të saj në proceset për sigurimin e mbështetjes institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës është përmirësuar

Me përkrahje nga Zyra Ligjore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës dhe UN Women, Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, nën udhëheqjen e Presidentes Atifete Jahjaga, me 15-18 janar 2015, organizoi punëtori në Tiranë. Punësoria mbledhi një delegacion nga Bosnia dhe Hercegovina, anëtarët e Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë, dhe pjesëmarrës të tjerë, për të shkëmbyer përvoja rreth rehabilitimit, ri-integrimit dhe fuqizimit të të mbijetuarve.

Me përkrahjen e UN Women, OHCHR dhe Zyrës Ligjore në Zyren e Kryeministrit, Këshilli ka filluar hartimin e udhëzimeve për zbatimin e Ligjit të ri për statutin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre (2014). Ky ligj, në mes tjerash, iu ofron atyre pernzione personale. Në mars të vitit 2015, Këshilli hartoi dhe finalizoi udhëzimet e nevojshme për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Këto



Anëtarët e RrGGK dhe Lobit dhuruan fustanat dhe fundet që ato kishin grumbulluar për të kontribuar në instalacionin artistik "Mendoj për ty"

dokumente do të ju mundësojnë personave që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës që të aplikojnë për përkrahje, siç është paraparë në Ligjin e lartëpërmendur, dhe bazuar në Protokolin Ndërkombëtarë për Dokumentim dhe Hetim, si dhe bazuar në praktikat më të mira nga rajoni.

Më tutje, prej 9 maj deri me 6 korrik, Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës organizoi aktivitete të ndryshme për të përmirësuar përkrahjen publike për personat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës. Nën udhëheqjen e Këshillit, RrGGK-ja, së bashku me anëtarët e saj dhe të Lobit, përkrahu instalacionin artistik “Mendoj për ty” të artistes Alketa Xhafa – Mripa, i cili iu dedikua grave të mbijetuara të dhunës seksuale të kryer gjatë luftës. RrGGK organizoi një sërë aktivitetsesh në mbarë Kosovën për të mbledhur fustane dhe funde për këtë ekspozitë, dhe më shumë se pesë mijë fustane dhe funde u mbledhën. Ato më pas u ekspozuan në Stadiumin e Prishtinës, me 12 korrik.

RrGGK poashtu morri pjesë në një panel diskutimi mbi temën: “Përkrahja e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës” të organizuar në Prizren gjatë festivalit të njohur të filmit “Dokufest”. Diskutimi synonte të ngriste vetëdijen publike mbi pasojat që dhuna seksuale ka mbi të mbijetuarit dhe shoqërinë, si dhe për rëndësinë e drejtësisë dhe njohjes.



MBËSHTETJA PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE

Qëllimi afat gjatë i këtij programi është që: gratë dhe burrat të kenë mundësi të barabarta ekonomike në shtëpi dhe në sferën publike.

Më shumë gra sigurojnë punësim

RrGGK ka bërë progres drejt këtij qëllimi afatgjatë që gratë të kenë qasje të barabarta në mundësitë e punësimit në Kosovë. Një tregues indikativ është numri i grave që kanë siguruar punësim përmes avokimit dhe/ose përkrahjes nga RrGGK dhe anëtarët e saj, i cili është rritur nga 24 në 241 në vitin 2015.

Institucionet dhe akterët kryesor më të vetëdijshëm për shkallën e diskriminimit gjinor në vendin e punës në Kosovë dhe mënyrat për të adresuar ato

Bazuar në një kërkesë zyrtare nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Z. Arban Abrashi, për dhënien e rekomandimeve për Ligjin e ri të Punës dhe në besimin tonë që një ligj i rëndësishëm si ky duhet të bazohet në fakte, RrGGK ka kryer hulumtim me qëllim që të informojë Ligjin e ri të Punës me të dhëna të bazuara në fakte, lidhur me temat që përfshijnë diskriminimin gjinor në punë, veçanërisht lidhur me pushimin e lehonisë dhe të atësisë. RrGGK ka kryer 400 intervista me një mostër të rastësishme të punëdhënësve. RrGGK poashtu ka anketuar 1,301 gra dhe 374 burra. RrGGK nuk ka gjetë fonde për këtë iniciativë dhe është varur nga kontributet e qytetarëve dhe në vullnetarizëm për të kryer këtë hulumtim



të rëndësishëm. Shumica e punës është kryer falë punës shtesë jashtë orarit të pjesëtareve të stafit të RrGGK-së dhe falë vullnetarëve e praktikanteve tanë të palodhshëm.

RrGGK prezantoi të gjeturat fillestare të këtij hulumtimi së bashku me rekomandimet kryesore pranë Këshillit Ekonomik-Social të Kosovës (KES) dhe së shpejti do t'ia dërgojë Ministrisë me shkrim rekomandimet e politikave. RrGGK planifikon t'i publikojë rekomandimet dhe t'i vërë ato në dispozicion për publikun në fillim të vitit 2016.

Më shumë mundësi, të përballueshme për përkujdesje të fëmijëve në dispozicion

RrGGK ka hartuar një dokument punues mbi rëndësinë e përkujdesit ndaj fëmijëve në Kosovë, i cili u prezantua tek përfaqësues të ndryshëm të institucioneve, akademikë, studentë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të donatorëve në Kosovë, gjatë konferencës së UBT-së mbi Ekonominë dhe Barazinë Gjinore, të mbajtur me 10 nëntor. RrGGK poashtu ka përfshirë rëndësinë e përkujdesit ndaj fëmijëve në mesin e rekomandimeve kryesore në dokumentin e politikave që do të prezantohet tek MPMS dhe KES, të cilët momentalisht janë duke e hartuar Ligjin e ri të Punës. RrGGK ka avokuar tek një numër zyrtarësh, përfshirë edhe ata nga Ministria dhe donatorët në Kosovë, për rëndësinë e hapjes të sa më shumë qendrave për përkujdesje të fëmijëve, të përballueshme financiarisht. Avokimi do të vazhdojë në vitet e ardhshme.



Përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe të sektorit privat për vendosjen e grave në vendet e punës

RrGGK ka bashkëpunuar me disa donatorë që kanë programe të cilat ndërlidhen me sektorin privat dhe punësimin e grave, si dhe ka përkrahur krijimin e Grupit Koordinues për Fuqizimin Ekonomik të Grave, që tani udhëhiqet nga *USAID EMPOWER* dhe ka marrë vazhdimisht pjesë në takimet e tij. RrGGK iu ka dhënë rekomandime disa donatorëve lidhur me strategjitë për arritjen e grave dhe identifikimin e mundësive potenciale të punësimit për to.

RrGGK ka bashkëpunuar me Open Data Kosovo dhe Girls Coding Kosovo për të ngritur fonde për një iniciativë të përbashkët për ofrimin e punësive adekuata dhe punës praktike për vajzat, në lëminë e zhvillimit të aplikacioneve për telefona të mençur. Ato po punojnë në zhvillimin e një aplikacioni specifik në të mirë të shoqërisë, të financuar nga *USAID EMPOWER*, Fondi Kanadez për Iniciativa Lokale (CFLI) dhe MPMS. Të tilla mundësi për punë praktike janë thelbësore që vajzat të mund të fitojnë përvoja të cilat mund t'i përdorin në identifikimin e mundësive dhe në aplikimin për punë në të ardhmen.

Siç u përmend, edhe stafi i RrGGK-së ka ofruar trajnime për qendrat rajonale të punësimit dhe qendrat për aftësi profesionale, me qëllim që të përkrahë zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve dhe aftësive të tyre për punësimin e grave.



Më shumë gra kanë qasje në trashëgimi dhe pronësi

RrGGK ka vazhduar bashkëpunimin me akterë të tjerë që punojnë në këtë drejtim, përfshirë edhe përmes Grupit Koordinues për Çështje Gjinore (GKÇGj) për Programin e të Drejtave Pronësore (PDP), themelimin e të cilit e përkrahu RrGGK në vitin 2015.

RrGGK ka kërkuar përkrahje financiare për të vazhduar iniciativat që do të përkrahin gratë në qasjen e të drejtave të tyre në trashëgimi dhe pronësi. Megjithatë, pasi që shumica e përpjekjeve deri më sot kanë qenë në baza vullnetare, RrGGK ende nuk e ka arritur këtë rezultat.



Partners Kosova ka informuar gratë dhe vajzat për të drejtat e tyre në trashëgimi dhe pronësi.

Më shumë qytetarë janë të vetëdijesuar lidhur me të drejtat e grave për trashëgimi dhe pronësi

Në vitin 2015, Partners Kosova filloi iniciativën “Avokimi i grave për barazi gjinore, e drejta e tyre për trashëgimi dhe pronësi” me 2,390 € nga Fondi i Grave të Kosovës i RrGGK-së. Iniciativa i ka informuar 34 gra dhe 26 burra nga Malisheva dhe Rahoveci mbi këto të drejta. Duke pasuar suksesin e kësaj iniciative, Partners Kosova në partneritet me OJQ Aureola (7,604 €) pranuan një Grant në Partneritet për Ndryshim.

Ato do të punojnë së bashku për te informuar gratë dhe vajzat në Vushtrri, Podujevë dhe Obiliq, në mënyrë që ato të mund t'i realizojnë të drejtat e tyre ligjore apo të trashëgimisë. Ato poashtu do të ofrojnë përkrahje të vazhdueshme për gratë që duan të regjistrojnë pronën ose trashëgiminë e tyre. Rezultatet e kësaj iniciative e cila është duke vazhduar, do të publikohen në vitin 2016.

Më shumë gra ndërmarrin hapa në drejtim të sigurimit të të drejtave të tyre për trashëgimi dhe pronësi

Gjatë vitit 2015, 294 gra dhe vajza kanë marrë pjesë në takime vetëdijësuese mbi të drejtat e tyre në pronë dhe trashëgimi. Ndërkaq, 47 prej tyre kanë kërkuar të drejtën e tyre të pronës dhe/ose trashëgimisë me përkrahjen anëtareve të RrGGK-së.

Zyrtarë të ndryshëm tregohen më të përgjegjshëm në respektimin e të drejtave të grave në trashëgimi dhe pronësi

Partners Kosova ka organizuar një tryezë të rrumbullakët në Rahovec lidhur me të drejtat e grave në trashëgimi dhe pronësi. Gratë e diskutuan këtë çështje me përfaqësuesit e gjykatave (gjyqtarët e gjykatave civile), të Zyrave për Ndihmë Juridike Falas, Zyrës për Barazi Gjinore, organizatave të grave, ndërmjetësuesve, me Drejtorin e Zyrës së Kadastrit dhe Gjeodezisë, Zyrën për Integritet, me mësimdhënës dhe studentë. RrGGK planifikon që në vitet e ardhshme, të ndërmarrë veprime shtesë së bashku me anëtarët e saj.



Përmirësohet qasja e grave në burimet familjare

RrGGK ka punuar në ngritjen e fondeve në këtë aspekt të strategjisë së saj gjatë këtij viti, gjë që ende nuk ka dhënë sukses, pamarrëparasysh propozimet e shumta të dorëzuara në vitin 2015.

Megjithatë, Shoqata e Juristëve NORMA dhe Qendra për Fuqizimin e Grave janë duke kontribuar në arritjen e këtij qëllimi duke avokuar për përmirësimin e zbatimit të së drejtës për përkrahje me alimentacion. Ato po avokojnë për një Udhëzues Administrativ të bazuar në Ligjin për Familjen që do të krijonte një mekanizëm të veçantë për monitorimin e zbatimit të së drejtës për alimentacion. Për këtë iniciativë, ato kanë pranuar një Grant në Partneritet për Ndryshim dhe do të vazhdojnë këto përpjekje në vitin 2016. Fakti më i rëndësishëm është që përkrahja me alimentacion do të mbështeste qasjen e grave në burime, veçanërisht në situatat e divorceve dhe/ose të dhunës në familje.

Kompletimi i hulumtimit mbi qasjen e barabartë në burimet familjare

RrGGK ka diskutuar me MPMS, GIZ dhe UNDP mbi rëndësinë e kryerjes së këtij hulumtimi. Edhe ky ishte në mesin e rekomandimeve të dala nga publikimi i RrGGK-së, *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*, i vitit 2015. RrGGK vazhdon të kërkojë përkrahje financiare me qëllim që kjo të zbatohet.



Vetëdija institucionale për modelet alternative të shpërndarjes së ndihmës sociale është përmirësuar

RrGGK ka planifikuar të përkrahë një vizitë studimore me MPMS-në në Shqipëri për të mësuar nga përvojat e tyre në shpërndarjen e ndihmës sociale për gratë. Megjithatë, për shkak të formimit të ngadalshëm të qeverisë dhe ndryshimeve politike në Ministri, ky plan është shtyer. RrGGK është në diskutime me MPMS-në dhe GLZ-in lidhur me atë se a do të vazhdojë të jetë e nevojshme kjo gjë në të ardhmen.

Përmirësohet shkalla në të cilën politikat dhe programet e BE-së përfshijnë perspektivën gjinore

Mbikëqyrja nga një perspektivë gjinore në lidhje me politikat dhe programet e BE-së në Kosovë është përmirësuar

Bashkimi Evropian (BE) ofron ndihmë financiare për vendet kandidate, si dhe për vendet kandidate potenciale. Pasi që Republika e Kosovës është një vend kandidat potencial, ajo gëtitashtu pranon fonde IPA. Në vitin 2015, RrGGK ka përkrahur ministritë dhe Delegacionin e BE-së në Kosovë në përfshirjen e perspektivës gjinore në Dokumentet e Veprimit IPA dhe Dokumentet e Planifikimit Sektorial (SPD).

Në total, RrGGK ka ofruar 18 sesione monitoruese dhe një punëtori për një numër total të 36 pjesëmarrësve (24 gra dhe 12 burra). Këto kanë kontribuar në rritjen e mirëkuptimit lidhur me atë se si mund të përfshihet perspektiva gjinore në dokumentet IPA. Për Zyrtarët për Barazi Gjinore, punëtorja dhe mentorimi kanë kontribuar në rritjen e njohurive të proceseve IPA, kornizave logjike, dhe për atë se



si ata mund të kontribuojnë në këto procese nga një perspektivë gjinore. Sa i përket dokumenteve, RrGGK ka ri-shikuar në total pesë drafte të Dokumenteve Sektoriale të Planifikimit dhe 15 drafte të Dokumenteve të Veprimit, duke ofruar të dhëna nga perspektiva gjinore. RrGGK poashtu ka ofruar komente që japin të dhëna nga perspektiva gjinore për Raportin e Progresit 2015 për Kosovën, si dhe ka ri-shikuar draftin e Programit Nacional për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nga perspektiva gjinore.

VLERËSIMI I PUNËS SË RrGGK

Në çdo takim dhe trajnim të organizuar gjatë këtij viti, anëtarët e RrGGK-së kanë vlerësuar punën e RrGGK-së përmes pyetësorëve që i kanë plotësuar në fund të secilës mbledhje. Në përgjithësi, anëtarët kanë vlerësuar shumë pozitivisht punën e RrGGK-së gjatë vitit 2015. Anëtarët kanë vlerësuar takimet e RrGGK si “shumë të rëndësishme” dhe “shumë të dobishme”, dhe punën e stafit si “të shkëlqyer”.



RAPORTI FINACIAR I RrGGK PËR VITIN 2015

Raporti i mëposhtëm financiar përfshinë informatat deri më 31 dhjetor 2015 dhe është version i audituar.

Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2014	Të pranuar në vitin 2015	Totali i fondeve	Shpenzimet	Grantet për anëtarët e RrGGK	Shpenzimet totale	Do të barten në vitin 2016
Austrian Development Agency 8299-01/2014	Iniciativa për vancimin e të drejtave të grave	211,317.96	20,802.41	232,120.37	130,640.46	37,814.00	168,454.46	63,665.91
External Action of the European Union 2014/352-636	Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile të udhëhequra nga gratë në Kosovë	105,801.96	-	105,801.96	41,391.93	59,868.95	101,260.88	4,541.08



Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2014	Të pranuar në vitin 2015	Totali i fondeve	Shpenzimet	Grantet për anëtarët e RrGGK	Shpenzimet totale	Do të barten në vitin 2016
Pagesat e anëtarësisë së OJQ-ve / Fondi i Qëndrueshmërisë	Pagesat e anëtarësisë së OJQ-ve / Fondi i qëndrueshmërisë	747.77	-	747.77	-	-	-	747.77
External Action of the European Union	Fuqizimi i rolit të rganizatave të shoqërisë civile të grave në romovimin e të drejtave njerëzore të grave dhe pjesëmarrjen politike	-	114,921.70	114,921.70	172.38	-	172.38	114,749.32

Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2014	Të pranuar në vitin 2015	Totali i fondeve	Shpenzimet	Grantet për anëtarët e RrGGK	Shpenzimet totale	Do të barten në vitin 2016
MOTT Foundation	Përkrahje e përgjithshme 2014-2015	-	22,334.20	22,334.20	22,334.20	-	22,334.20	-
GIZ 83201028	Reformimi i sistemit financiar në Kosovë	-	17,739.00	17,739.00	17,739.00	-	17,739.00	-
GIZ 83207641	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinnor	-	5,425.00	5,425.00	1,050.00	-	1,050.00	4,375.00
IPA 32/2015-IPA2013	Përkrahje për përfshirjen e perspektives gjinore në Programin IPA 2015 në Kosovë	-	19,999.00	19,999.00	19,999.00	-	19,999.00	-

Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2014	Të pranuarë në vitin 2015	Totali i fondeve	Shpenzimet	Grantet për anëtarët e RrGGK	Shpenzimet totale	Do të barten në vitin 2016
Zyra e Presidentes	Përkrahje për fushatën "Mendoj për ty" 2015	-	2,333.33	2,333.33	2,333.33	-	2,333.33	-
Ambasada Mbretërore e Hollandës	Fuqizimi i rolit të rganizatave të shoqërisë civile të udhëhequra nga gratë në promovimin e të drejtave të grave PRI/15/MATR A/22	-	14,942.00	14,942.00	13,792.00	-	13,792.00	1,150.00

Donatorët	Projektet	Të barta nga viti 2014	Të pranua në vitin 2015	Totali i fondeve	Shpenzimet	Grantet për anëtarët e RrGGK	Shpenzimet totale	Do të barten në vitin 2016
Kvinna till Kvinna	"Avancimi i barazisë gjinore në procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE" -project number – KO01SID16-31004	-	14,545.00	14,545.00	4,032.75	-	4,032.75	10,512.25
East West Management Institute	Iniciativa e Historisë Gojore	-	4,721.19	4,721.19	2,680.12	-	2,680.12	2,041.07
National Endowment for Democracy	Iniciativa e Historisë Gojore	-	30,572.13	30,572.13	30,572.13	-	30,572.13	-

Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2014	Të pranuar në vitin 2015	Totali i fondeve	Shpenzimet	Grantet për anëtarët e RrGGK	Shpenzimet totale	Do të barten në vitin 2016
Anëtarësimi individual / Marta Druri	Përkrahje për Gjykatën e Grave në Sarajevë	-	445.00	445.00	445.00	-	445.00	-
Anëtarësimi individual /2015		-	-	-	-	-	-	-
Nuriye Cacaj		-	30.00	-	-	-	-	-
Ermira Cacaj		-	10.00	-	-	-	-	-
Englantina Shala		-	10.00	-	-	-	-	-
Aferdita Thaqi		-	30.00	-	-	-	-	-
Fatime Jasiqi		-	10.00	-	-	-	-	-
GAEA Tours, Switzerland		-	100.00	-	-	-	-	-

Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2014	Të pranuar në vitin 2015	Totali i fondeve	Shpenzimet	Grantet për anëtarët e RrGGK	Shpenzimet totale	Do të barten në vitin 2016
Nicole Farnsworth		-	6,053.15	-	-	-	-	-
Elisabeth Kastli		-	70.00	-	-	-	-	-
Besa Shehu		-	950.00	-	-	-	-	-
Igballe Rogova		-	500.00	-	-	-	-	-
Sherafedin Shehu		-	60.00	-	-	-	-	-
Nicole Farnsworth		-	169.01	-	-	-	-	-
Zn. Susan dhe Z. Frank Farnsworth		-	845.07	-	-	-	-	-
Arlinda Kadriu dhe Dua Kadriu		-	60.00	-	-	-	-	-

Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2014	Të pranuar në vitin 2015	Totali i fondeve	Shpenzimet	Grantet për anëtarët e RrGGK	Shpenzimet totale	Do të barten në vitin 2016
Totali i pagesave të anëtarësimit individual	Hulumtimi mbi Ligjin e Punës i financuar nga RrGGK	-	-	8,897.23	5,929.84		8,203.25	693.98
Anëtarësimi individual	Printimi i materialeve të ndryshme promovuese të RrGGK	-	-		714.41	-	-	-
Anëtarësimi individual	Përkrahje për QGMF renas për fushatën "Mendoj për ty"	-	-	-	-	500.00	-	-
Anëtarësimi individual	Përkrahje për Artpolis për Festivalin FemArt	-	-	-	-	500.00	-	-
Anëtarësimi individual	Përkrahje për organizatën Vita Jeta	-	-	-	-	300.00	-	-

Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2014	Të pranuar në vitin 2015	Totali i fondeve	Shpenzimet	Grantet për anëtarët e RrGGK	Shpenzimet totale	Do të barten në vitin 2016
Anëtarësimi individual	Përkrahje për Çerdhen Ngjyrat në Ajvali	-	-	-	259.00	-	-	-
Totali i pagesave të anëtarësisë së OJQ-ve		-	1,100.00	1,100.00	-	-	-	1,100.00
Total		317,867.69	278,777.19	596,644.88	294,085.55	98,982.95	393,068.50	203,576.38

INDEPENDENT AUDITOR'S REPORT

To: **EXECUTIVE MANAGEMENT OF KOSOVO WOMENS NETWORK (KWN)**
PRISHTINA

We have audited the costs and supplementary financial data of Kosovo Women's Network (KWN) expresses in EUR, for the period ended December 31, 2015. We expressed an unqualified audit opinion on those financial statements in our report dated 15 April 2016

Management's Responsibility for the Summary Financial Statements

Management is responsible for preparing financial statements and supplementary financial data. This responsibility includes designing, implementing and maintaining internal control relevant to the preparations and fair presentation of financial statements that are free from material misstatements, prove income and expenditure according the budget.

Auditor's Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on the aforementioned financial information based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we plan and perform the audit to obtain reasonable assurance about whether the reporting forms are free of material misstatement. An audit includes examining, on a test basis, evidence supporting the amounts and disclosures in the reporting forms. An audit also includes assessing the accounting principles used and significant estimates made by management, as well as evaluating the proper accounting and reporting of the data on the financial statements. We believe that our audit provides a reasonable basis for our audit opinion.

Opinion

In our opinion, the summary financial statements derived from the audited financial statements of Kosovo Women's Network (KWN) expresses in EUR, for the period ended December 31, 2015 are a fair summary of those financial statements in accordance with the International Financial Reporting Standards.


Xhemail Sylja
Statutory auditor
"SyljaHotia" #1
Pristine

Xhemail Sylja
XHEMAIL SYLJA
Statutory Auditor
044/174 510 111

15.04.2016



Përqindja e shpenzimeve operative dhe të programit për 2015



Siç ilustron në grafik, 11% e shpenzimeve të RrGGK janë bërë për shpenzime operative dhe 39% për shpenzime të programit. Shpenzime tjera të programit përfshijnë grantet e dhëna nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës total 16%. Deri në fund të vitit 2015 34% e fondeve janë bartur për tu shpenzuar gjatë vitit 2016.

PËR NE

Bordi Drejtues i RrGGK

Ariana Qosaj-Mustafa, Kryetare e Bordit, Aktiviste për të Drejtat e Grave

Sevdije Ahmeti, Aktiviste për të Drejtat e Njeriut

Hajrulla Çeku, Drejtor Ekzekutiv, *OJQ Ec ma ndryshe*

Belgijzare Muharremi, Drejtore Ekzekutive, *OJQ Dera e Hapur*

Zana Hoxha Krasniqi, Drejtore Ekzekutive, Artpolis

Besim M. Kajtazi, Drejtor i Zyrës Ligjore, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës

Nermin Mahmuti, Drejtore Ekzekutive, Community Development Fund (CDF)

Bordi Këshillëdhënës i RrGGK

Delina Fico, Rachel Wareham, Behar Selimi, Vjosa Dobruna, Marte Prekpalaj, Shqipe Malushi, Lepa Mladjenovic

Anëtarët e Stafit të RrGGK në vitin 2015

Igballe (Igo) Rogova, Drejtore Ekzekutive

Besa Shehu, Menaxhere Financiare & Administrative

Nicole Farnsworth, Menaxhere e Programit dhe Udhëheqëse e Hulumtimeve



Zana Rudi, Menaxhere e Projektit
Nertila Qarri, Koordinatore e Projektit
Mimoza Pachuku, Menaxhere për Fondin e Grave të Kosovës
Donjetë Berisha, Koordinatore për Mardhënie me Publikun
Donjeta Morina, Koordinatore për Zhvillim të Kapaciteteve
Adelina Berisha, Asistente e Hulumtimit
Iliriana Banjska, Asistente e Projektit
Dhurata Azemi, Asistente e Projektit (Gusht - Dhjetor)
Gresa Rrahmani, Asistente e Hulumtimit (Nëntor - Dhjetor)
